



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 229

Tiranë – E premte, 25 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 108/2016 datë 27.10.2016	Për një ndryshim dhe disa shtesa në ligjin nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”..... 23823
Ligj nr. 109/2016 datë 27.10.2016	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, të ndryshuar..... 23823
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 16.11.2016	Për përcaktimin e rregullave të verifikimit kufitar që zbatohen për kategori të caktuara të personave dhe mjeteve..... 23824
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 16.11.2016	Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore..... 23833
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 16.11.2016	Për miratimin e licencës së koncesionit për rafineri shoqërisë aksionare “RBH Beline”..... 23833
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 16.11.2016	Për miratimin e rregullores “Për zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)”..... 23835
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 16.11.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 198, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, të ndryshuar..... 23860
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 16.11.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 608, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, të ndryshuar”..... 23860
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 16.11.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”..... 23862

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 16.11.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”	23863
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 16.11.2016	Për miratimin e rregullores “Për transportin e sigurt të materialeve radioaktive”	23864
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 16.11.2016	Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”	23872
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 7790, datë 24.11.2016	Për delegim kompetence.....	23873



LIGJ
Nr. 108/2016

**PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA
NË LIGJIN NR. 8730, DATË 18.1.2001, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT
GJYQËSOR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 12, pika 2 shfuqizohet.

Neni 2

Pas nenit 12 shtohen nenet 12/a dhe 12/b me këtë përmbajtje:

“Neni 12/a

Tarifat fikse të veprimeve përmbartimore

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse. Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbartimor.

Masa e tarifës fikse të veprimit përmbartimor, llojet e veprimeve përmbartimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Neni 12/b
Tarifa e suksesit

Përmbartuesi gjyqësor shtetëror përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi

vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbartuesit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbartimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

Marrëveshja tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror miratohet me urdhër nga Ministri i Drejtësisë.”.

Neni 3

Akte nënligjore

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave të nxjerrin aktet e përcaktuara në nenet 12/a dhe 12/b brenda 30-ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore do të zbatohen tarifat e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9870, datë 21.11.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 109/2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
10 031, DATË 11.12.2008, “PËR SHËRBIMIN
PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 47

Tarifat fikse të veprimeve përmbartimore

Për fillimin e procedurave të ekzekutimit dhe kryerjen e veprimeve procedurale nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Privat, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, paguhet tarifa fikse.

Masa e tarifës fikse caktohet duke mbajtur në konsideratë vlerën dhe llojin e detyrimit, si dhe kompleksitetin e veprimit procedural përmbartimor.

Masa e tarifës fikse të veprimit përmbartimor, llojet e veprimeve përmbartimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi merret dhe mendimi i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.”.

Neni 2

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 48

Tarifa e suksesit

Përmbartuesi gjyqësor privat përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar. Masa e tarifës së suksesit caktohet në marrëveshjen mes kreditorit dhe përmbartuesit gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave përcaktojnë me udhëzim të përbashkët nivelin minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbartimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.”.

Neni 3

Aktet në nënligjore

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet e përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore do të zbatohen tarifat e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.10.2016

Shpallur me dekretin nr. 9871, datë 21.11.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 806, datë 16.11.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË VERIFIKIMIT KUFITAR QË
ZBATOHEN PËR KATEGORI TË
CAKTUARA TË PERSONAVE DHE
MJETEVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 14, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me rregulloren (BE) 2016/399, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 9 mars 2016, “Për një kod të Bashkimit mbi rregullat e regjimit të lëvizjes së personave në kufij (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 77, datë 23.3.2016, faqe 1–52.



VENDOSI:

KREU I

RREGULLA TË VEÇANTA TË
VERIFIKIMIT KUFITAR QË ZBATOHEN
PËR KATEGORI TË ÇAKTUARA TË
PERSONAVE

1. Krerët e shteteve dhe personalitetet

a) Krerët e shteteve, kryetarët e parlamenteve, kryetarët e qeverive dhe homologët e tyre, personalitetet dhe anëtarët e delegacioneve që i shoqërojnë, mbërritja dhe largimi i të cilëve është lajmëruar zyrtarisht nëpërmjet kanaleve diplomatike, kanë prioritet kundrejt udhëtarëve të tjerë.

b) Si rregull, këta persona i nënshtrohen verifikimit minimal dhe regjistrimit të hyrje-daljeve bazuar vetëm në të dhënat e njoftimit zyrtar ose dokumenteve të udhëtimit.

c) Në rastet e dyshimeve serioze mbi vërtetësinë e identitetit ose dokumentit, rojet kufitare gëzojnë të drejtën të kryejnë verifikimin përkatës.

ç) Çdo vendim, që lidhet me problematikën që mund të rezultojë nga verifikimi minimal, merret dhe zbatohet në komunikim e konsultim me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

2. Mbajtësit e pasaportave diplomatike zyrtare ose të pasaportave të shërbimit dhe anëtarët e organizatave ndërkombëtare

a) Mbajtësve të pasaportave diplomatike, zyrtare apo të shërbimit, si dhe mbajtësve të dokumenteve të lëshuara nga organizatat ndërkombëtare, sipas përcaktimeve në pikën 2.1, të cilët udhëtojnë për qëllim dhe në zbatim të detyrave për të cilat janë pajisur me dokumentin përkatës, u jepet përparësi kundrejt udhëtarëve të tjerë gjatë verifikimit kufitar në pikat e kalimit kufitar, pavarësisht nëse, sipas rastit, u nevojitet ose jo pajisja me vizë.

b) Anëtarët e akredituar të misioneve diplomatike dhe të përfaqësive konsullore si dhe familjarët e tyre mund të kalojnë kufirin duke paraqitur kartën speciale të lëshuar nga Ministra e Punëve të Jashtme dhe dokumentin që i autorizon të kalojnë kufirin.

c) Për efekt të përjashtimit nga neni 14, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, personave të parashikuar në këtë pikë nuk u kërkohet të provojnë se kanë mjete të mjaftueshme financiare për jetesë.

ç) Rojet kufitare nuk refuzojnë hyrjen ose daljen e personave që përcaktohen në shkronjën “a” pa u konsultuar më parë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, qoftë edhe kur ekziston një shënim në bazat e të dhënave që konsultohen për efekt të verifikimit kufitar.

d) Në qoftë se, për efekt të verifikimit kufitar, një person kërkon privilegje, imunitete dhe përjashtime që u takojnë personave të sipërpërmendur, rojet kufitare i kërkojnë pretenduesit të paraqesë dëshmi për statusin e pretenduar, siç mund të jenë vërtetimet e lëshuara nga shteti akreditues, pasaporta diplomatike ose dokumente të tjera vërtetuese. Në raste urgjente dhe kur roja kufitare ende ka dyshime për statusin, njoftohen instancat eprore të Policisë Kufitare dhe të Migracionit, të cilat i kërkojnë konfirmim për këtë status Ministrisë së Punëve të Jashtme.

2.1 Anëtarë të organizatave ndërkombëtare, në kuptimin e kësaj pike, konsiderohen të gjithë ata persona që posedojnë dokumentet e mëposhtme:

- Leje kalimi (*laissez-passer*) e lëshuar nga Kombet e Bashkuara për personelin e Kombeve të Bashkuara dhe agjencive në varësi, sipas Konventës për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 21 nëntor 1947, në Nju-Jork;

- Leje kalimi (*laissez-passer*) e Bashkimit Evropian;

- Leje kalimi (*laissez-passer*) e Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (Euratom);

- Certifikatë legjitimiteti e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës;

- Dokumentet e lëshuara sipas paragrafit 2, të nenit III, të marrëveshjes midis palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), për sa i përket statusit të Forcës së tyre (kartat ushtarake të identitetit, të shoqëruara me urdhër udhëtimi, mandate udhëtimi ose urdhër individual apo kolektiv lëvizjeje), si dhe dokumentet e lëshuara në kuadrin e partneritetit për paqe;

- Dokumente të tjera që Republika e Shqipërisë i njeh të barasvlershme me të mësipërmet, për shkak të një vendimi të njëanshëm apo të një përcaktimi të tillë në një marrëveshje.

3. Anëtarët e shërbimeve të sigurisë

a) Anëtarëve të shërbimeve të sigurisë, të cilët hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë, duke shoqëruar apo për të shoqëruar personalitete ose



delegacione zyrtare, si dhe anëtarëve të shërbimeve të sigurisë të cilët mbërrijnë ose largohen nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të një marrëveshjeje apo të një njoftimi zyrtar, nga Ministria e Punëve të Jashtme ose Ministria e Punëve të Brendshme, për të marrë pjesë në një aktivitet që zhvillohet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, parimisht u jepet përparësi kundrejt udhëtarëve të tjerë gjatë verifikimit kufitar në pikat e kalimit kufitar, pavarësisht nëse, sipas rastit, u nevojitet ose jo pajisja me vizë.

b) E njëjta përparësi, si në shkronjën “a” u njihet edhe anëtarëve të shërbimeve të sigurisë, të cilët kalojnë transit në Republikën e Shqipërisë, kur kalojnë kufirin për arsye të kryerjes së detyrave të parashikuara në shkronjën “a”, në kuadër të një marrëveshjeje të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë apo të një njoftimi zyrtar nga Ministria e Punëve të Jashtme ose Ministria e Punëve të Brendshme.

c) Kur anëtarët e shërbimeve të sigurisë kërkojnë të kalojnë kufirin e Republikës së Shqipërisë të armatosur, aparati qendror i Policisë Kufitare dhe të Migracionit lëshon lejen për kalimin e kufirit nga anëtari i shërbimeve të sigurisë i armatosur, pas njoftimit paraprak nga Ministria e Punëve të Jashtme ose Ministria e Punëve të Brendshme, me kusht që kalimi të jetë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Në lejen në fjalë përcaktohen kushtet e veçanta për hyrje.

ç) Për efekt të përjashtimit nga neni 14, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, këtyre personave nuk u kërkohet të provojnë se kanë mjete të mjaftueshme financiare.

d) Çdo vendim, që lidhet me problematikën që mund të rezultojë nga verifikimi minimal për këtë kategori, merret dhe zbatohet në komunikim e konsultim me Ministrinë e Punëve të Jashtme ose Ministrinë e Punëve të Brendshme, varësisht nga autoriteti që ka kryer njoftimin.

4. Anëtarët e shërbimeve të kërkim-shpëtimit, të mbrojtjes nga zjarri, policisë dhe punonjësit e kufirit

a) Punonjësve të parashikuar në këtë pikë, të cilët udhëtojnë për qëllim dhe zbatim të detyrave përkatëse, parimisht u jepet përparësi kundrejt udhëtarëve të tjerë gjatë verifikimit kufitar në pikat e kalimit kufitar, pavarësisht nëse, sipas rastit, u

nevojitet ose jo pajisja me vizë.

b) Për efekt të përjashtimit nga neni 14, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, këtyre personave nuk u kërkohet të provojnë nëse kanë mjete të mjaftueshme financiare për jetesë, në rastet kur udhëtojnë për qëllim dhe zbatim të detyrave përkatëse.

5. Të miturit

a) Të miturit që kalojnë kufirin u nënshtrohen të gjitha verifikimeve, në hyrje dhe në dalje, si dhe të rriturit.

b) Në rastin e të miturve të shoqëruar, punonjësi i kufirit verifikon nëse personi/at shoqërues të të miturit janë përfaqësues ligjorë të tij ose e kanë atë nën kujdes prindëror, sidomos kur i mituri shoqërohet vetëm nga një person madhor.

c) Kur ka arsye serioze për të dyshuar se i mituri mund të jetë shpëputur në mënyrë të paligjshme nga kujdestaria e personit/ave që ushtron/jnë ligjërisht kujdesin prindëror apo nga përfaqësuesi ligjor i tij, rojet kufitare duhet të kryejnë dhe verifikime të mëtejshme, duke vlerësuar e zbuluar mospërputhjet apo kontradiktat në informacionin e dhënë.

ç) Në rastin e të miturve që udhëtojnë të pashoqëruar, rojet kufitare sigurojnë, me anë të shqyrtimit të imët të dokumenteve të udhëtimit, dokumenteve mbështetëse, bazave të të dhënave dhe intervistimit që të miturit të mos kalojnë kufirin kundër dëshirës së personit/ave që ka/kanë kujdestarinë prindërore apo përfaqësuesit ligjor të të miturit.

d) Pika Kombëtare e Kontaktit për konsultimin për çështje të të miturve përcaktohet me urdhër të Kryeministrit.

dh) Rojet kufitare konsultohen me Pikën Kombëtare të Kontaktit, të parashikuar në shkronjën “d”, për rastet e veçanta, kur të dhënat e informacioni që posedojnë dhe marrin gjatë verifikimit kufitar të të miturve që kalojnë kufirin nuk krijojnë mundësinë për një verifikim të plotë të situatës në fjalë.

e) Për efekt të unifikimit të procedurës së verifikimit kufitar të të miturve, ministri i Punëve të Brendshme nxjerr udhëzim për rastet e kalimit të të miturve që kushtëzojnë përcaktimin e rregullave të veçanta më të detajuara.

6. Punonjësit ndërkuftarë

a) Verifikimi i punonjësve ndërkuftarë kryhet sipas rregullave të përgjithshme për kontrollin



kufitar, veçanërisht sipas neneve 6 dhe 14, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”.

b) Për efekt të përjashtimit nga neni 14, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, punonjësit ndërkufitarë, që njihen mirë prej rojeve kufitare, për shkak të kalimeve të tyre të shpeshta në kufi në të njëjtën pikë kalimi kufitar dhe për të cilët gjatë një verifikimi të mëparshëm nuk është shfaqur ndonjë njoftim nga ndonjë regjistër apo bazë të dhënash, kur kalojnë kufirin për arsye të punës së tyre, pavarësisht nga shtetësia, u nënshtrohen verifikimeve minimale.

c) Ndaj këtyre personave ushtrohen herë pas here verifikime tërësore ose dhe verifikime të detajuara, pa paralajmërim dhe jo në intervale të rregullta.

7. Pilotët dhe anëtarët e tjerë të ekuipazhit të mjeteve ajrore

a) Për efekt të përjashtimit nga neni 14, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, mbajtësit e licencës së pilotit ose të certifikatës së anëtarit të ekuipazhit, të lëshuara sipas parashikimeve të shtojcës 9, të Konventës për Aviacionin Civil, të datës 7 dhjetor 1944, pavarësisht nga shtetësia që mbajnë, u nënshtrohen verifikimeve minimale, kur paraqesin këto dokumente dhe kur për arsye të ushtrimit të detyrave të tyre u nevojitet:

i) të hipin dhe të zbresin në aeroportin e ndalesës ose në aeroportin e mbërritjes;

ii) të hyjnë në territorin e njësisë administrative të aeroportit të ndalesës ose të aeroportit të mbërritjes;

iii) të shkojnë, me çfarëdolloj mjeti transporti në aeroportin ku gjendet mjeti ajror në të cilin ata imbarkohen për nisje.

b) Kur është e mundur, ekuipazheve të mjeteve ajrore, që kalojnë kufirin për arsye të kryerjes së detyrave të tyre, u jepet përparësi kundrejt udhëtarëve të tjerë gjatë verifikimit kufitar në pikat e kalimit kufitar, duke kryer verifikimin përpara pasagjerëve ose në vende të veçanta të caktuara për këtë qëllim.

c) Për efekt të përjashtimit nga neni 14, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, ekuipazhet, që kalojnë kufirin për arsye të kryerjes së detyrave të tyre dhe që njihen nga rojet kufitare, u nënshtrohen në përgjithësi verifikimeve minimale.

ç) Në të gjitha rastet e tjera zbatohen kërkesat e verifikimeve kufitare të parashikuara nga ligji

nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, si për çdo person tjetër.

8. Detarët

a) Detarët që mbajnë një dokument identifikimi detarësh, të lëshuar në përputhje me Konventën nr. 108 (1958) ose nr. 185 (2003) të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për Dokumentet e Identifikimit të Detarëve, të Konventës për Lehtësimin e Trafikut Detar Ndërkombëtar (Konventa FAL), mund të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke zbritur në tokë në zonën e portit ku mbërrijnë anijet e tyre ose në njësitë administrative më të afërta apo të dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë duke u kthyer në anijet e tyre, pa u paraqitur vetë në një pikë kalimi kufitar, me kusht që të kenë emrin e regjistruar në listën e ekuipazhit të anijes së cilës i përkasin, listë kjo që u është dorëzuar më parë për verifikim rojeve kufitare.

b) Mbi bazën e vlerësimit të risqeve për sigurinë e brendshme dhe emigracionin e paligjshëm, detarët u nënshtrohen një verifikimi sipas parashikimeve të nenit 14, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, përpara se të zbarkojnë në breg.

9. Punonjësit e platformave në det të hapur (*Offshore*)

a) Për efekt të përjashtimit nga neni 14, i ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, punonjësit e platformave që gjenden në ujërat territoriale apo në zonën e shfrytëzimit ekskluziv ekonomik detar, të cilët kthehen rregullisht nga deti ose ajri në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa hyrë apo qëndruar në territorin e një vendi tjetër, nuk verifikohen sistematikisht.

b) Rojet kufitare marrin në konsideratë vlerësimin e risqeve të migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar e atij mjedisor, sidomos aty ku vija bregdetare e një vendi tjetër apo itineraret e qarkullimit gjenden në afërsi të vendndodhjes së platformës, me qëllim që të përcaktohet dendësia e verifikimeve kufitare që kryhen ndaj këtyre punonjësve.



KREU II

RREGULLA TË VEÇANTA TË
VERIFIKIMIT KUFITAR QË ZBATOHEN
PËR KATEGORI TË ÇAKTUARA TË
PERSONAVE QË UDHËTOJNË ME MJETE
TË NDRYSHME TË TRANSPORTIT SIPAS
LLOJIT TË KUFIJVE

10. Automjetet e qarkullimit rrugor

a) Si rregull, personat që udhëtojnë në autovetura mund të qëndrojnë brenda automjetit gjatë verifikimeve kufitare.

b) Megjithatë, nëse e kërkojnë rrethanat, personave që udhëtojnë me autovetura mund t'u kërkohej të zbresin nga automjetet.

c) Verifikimet kufitare ndaj drejtuesve të automjeteve të rënda dhe personave të tjerë që gjenden në këto mjete kryhen ndërsa personat janë në automjet dhe kryhen të ndara nga udhëtarët e tjerë, atje ku ekziston mundësia fizike për një verifikim të tillë të ndarë.

ç) Personat që udhëtojnë me autobus i nënshtrohen verifikimit kufitar individual si udhëtarë këmbësorë, në терминалет përkatëse të autobusëve apo ambientet e posaçme si dhe brenda në autobus, kur kjo gjë vlerësohet e nevojshme nga rojet kufitare.

d) Në rast qarkullimi të rënduar i jepet përparësi verifikimit të udhëtarëve në autobusët e linjave të rregullta.

dh) Nëse nuk parashikohet posaçërisht ndryshe në marrëveshjen përkatëse dhe nëse rrethanat e mundësojnë, mënyra e verifikimit kufitar të personave që udhëtojnë me automjete është e njëjtë sipas parashikimeve të mësipërme edhe në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar.

11. Mjetet e qarkullimit hekurudhor

a) Në trenat që kalojnë kufirin, verifikimet kufitare kryhen si te pasagjerët e trenit, ashtu edhe te personeli i hekurudhës, qofshin ata trena mallrash apo trena bosh.

b) Me qëllim lehtësimin e qarkullimit hekurudhor, bazuar në marrëveshjet përkatëse, verifikimet kufitare kryhen në cilëndo prej mënyrave të mëposhtme:

i) Në stacionin e parë të mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në hyrje dhe në stacionin e fundit të nisjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në dalje dhe anasjelltas në territorin e shtetit, palë në marrëveshje;

ii) Brenda në tren, gjatë udhëtimit nga stacioni i fundit i nisjes në territorin e shtetit palë në marrëveshje deri në stacionin e parë të mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në hyrje dhe anasjelltas në dalje.

c) Për të lehtësuar qarkullimin hekurudhor të trenave të shpejtë me pasagjerë, bazuar në marrëveshjet përkatëse për verifikime kufitare të përbashkëta me palët, verifikimet kryhen nga rojet kufitare të palëve në cilëndo prej mënyrave të mëposhtme:

i) Në stacionin e parë të mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në hyrje dhe anasjelltas në territorin e shtetit palë në dalje;

ii) Në stacionin e parë të nisjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në dalje dhe anasjelltas në territorin e shtetit palë në hyrje;

iii) Në një stacion të vendosur bashkërisht nga palët, pavarësisht nga territori i vendndodhjes së këtij stacioni ose nga drejtimi i lëvizjes;

iv) Brenda në tren, gjatë udhëtimit nga stacioni i fundit i nisjes në territorin e shtetit palë në marrëveshje deri në stacionin e parë të mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në hyrje dhe anasjelltas në dalje;

v) Brenda në tren, gjatë udhëtimit nga një stacion nisjeje në territorin e njëres palë deri në një stacion mbërritjeje në territorin e palës tjetër, të përcaktuar bashkërisht nga palët, pavarësisht nga drejtimi i lëvizjes, me kusht që rojet kufitare të sigurohen se udhëtarët nuk mund t'i shmangen verifikimit kufitar.

ç) Verifikimet e përbashkëta, të parashikuara në shkronjën "c" mund të zbatohen dhe në rastet e trenave të mallrave apo trenave bosh, kur synohet qarkullimi i shpejtë i mallrave dhe ka një marrëveshje përkatëse mes palëve.

d) Nëse për trenin, që kalon kufirin në hyrje, ka brenda territorit të Republikës së Shqipërisë disa stacione ku hipin pasagjerë, ata u nënshtrohen verifikimeve kur hyjnë në tren ose në stacionin e mbërritjes, me qëllimin për t'u siguruar se nuk kanë shmangur verifikimin kufitar.

dh) Personat, që dëshirojnë të marrin trenin vetëm për pjesën e mbetur të udhëtimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, njoftohen paraprakisht nga transportuesi hekurudhor nëse do t'u nënshtrohen verifikimeve në hyrje, gjatë udhëtimit ose në stacionin e mbërritjes sipas parashikimit të shkronjës "d".



e) Transportuesi hekurudhor merr masat përkatëse që personat që udhëtojnë në tren të mos kenë mundësi t'u shmangen verifikimeve kufitare.

ë) Rojet kufitare mund të urdhërojnë inspektimin e hapësirave të tjera në brendësi të trenit dhe vagonëve, nëse nevojitet edhe me ndihmën e kontrollorit të trenit, për t'u siguruar që personat apo sendet që duhet t'u nënshtrohen verifikimeve kufitare të mos jenë fshehur aty.

f) Kur ka arsye për të besuar se në tren janë fshehur persona që janë në kërkim ose që dyshohen se kanë kryer një vepër penale apo shtetas të huaj që synojnë të hyjnë në mënyrë të paligjshme, rojet kufitare, nëse nuk kanë mundësi të veprojnë për shkak të mungesës së juridiksionit në zbatimin e legjislacionit kombëtar, njoftojnë punonjësit e shtetit që kanë kompetencën për veprim.

12. Mjetet e qarkullimit ajror

a) Në aeroportet ndërkombëtare, verifikimi kufitar për personat, që përdorin fluturime jo të lidhura me transferta, kryhet në hyrje dhe në dalje, respektivisht në mbërritje dhe në nisje, në vendet e posaçme, të përshtatura për verifikim kufitar.

b) Në aeroportet ndërkombëtare, verifikimi kufitar për personat, që përdorin fluturime të lidhura me transferta, gjatë të cilave zbresin dhe hipin pasagjerë, kryhet respektivisht në hyrje dhe në dalje, në aeroportin e parë në mbërritje ku mundësohet ndryshimi i pasagjerëve dhe në aeroportin e fundit në nisje ku mundësohet ndryshimi i pasagjerëve, në vendet e posaçme, të përshtatura për verifikim kufitar.

c) Në aeroportet ndërkombëtare, verifikimi kufitar për personat, që përdorin fluturime të lidhura me transferta, gjatë të cilave nuk zbresin dhe nuk hipin pasagjerë, kryhet respektivisht në hyrje dhe në dalje, në aeroportin e fundit në mbërritje dhe në aeroportin e parë në nisje, në vendet e posaçme, të përshtatura për verifikim kufitar.

ç) Personat, që janë subjekt i verifikimeve kufitare dhe që gjatë fluturimeve të lidhura me transferta qëndrojnë në bordin e të njëjtit mjet ajror, pa iu dhënë mundësia për të zbritur, megjithëse në aeroportin e transfertës mundësohet ndryshim pasagjerësh, verifikohen në hyrje dhe në dalje, respektivisht në aeroportin e parë të

mbërritjes ku u mundësohet zbarkimi dhe në aeroportin e fundit të nisjes ku u mundësohet imbarkimi.

d) Personat, që udhëtojnë me mjete ajrore në aerodromet që nuk kanë statusin e aeroportit ndërkombëtar, por në të cilat janë të lejueshme itineraret e lëvizjeve që bëhen subjekt i verifikimit kufitar për shkak të lidhjeve me udhëtime të tjera ndërkombëtare, u nënshtrohen verifikimeve kufitare në hyrje dhe në dalje, sipas parashikimeve përkatëse të shkronjave "b", "c" dhe "ç", varësisht nga lloji i transfertave.

dh) Në aerodromet e parashikuara në shkronjën "d", të cilat nuk kanë statusin e aeroportit ndërkombëtar, nuk është e detyrueshme prania e përhershme e rojeve kufitare, por kjo garantohej brenda një kohe të arsyeshme në bazë të njoftimit nga administratori/operatori i aerodromit kur trafiku është i rrallë apo i paplanifikuar ose në bazë të parashikimeve të marrëveshjes përkatëse me administratorin e aerodromit, kur udhëtimet janë të planifikuara.

e) Si rregull, verifikimet kufitare nuk kryhen në avion apo te hyrja për në avion ose në zonën e transitit, me përjashtim të rastit kur kjo justifikohet mbi bazën e një vlerësimi të rreziqeve që lidhen me sigurinë e brendshme dhe imigrimin e paligjshëm.

ë) Në rastin e fluturimeve për qëllime private, që kalojnë kufirin dhe janë subjekt i verifikimeve kufitare, piloti në komandë u transmeton rojeve kufitare, para nisjes, një deklaratë të përgjithshme që përmban, ndër të tjera, një plan fluturimi në përputhje me shtojcën 2 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe informacion në lidhje me identitetin e pasagjerëve.

f) Kur gjatë fluturimeve për qëllime private në hyrje bëhen disa ndalesa të llojit të fluturimeve të brendshme, rojet kufitare, në pikën ku mjeti zbrit për herë të parë, kryejnë verifikime kufitare dhe vendosin një vulë hyrjeje në deklaratën e përgjithshme të përmendur në shkronjën "ë".

g) Kur nuk është i sigurt destinacioni ose origjina apo transiti i fluturimit privat, rojet kufitare kryejnë verifikime kufitare të personave, në përputhje me parashikimet për verifikimet kufitare në aeroporte dhe aerodrome, varësisht nga lloji i fluturimit privat.

gj) Operatori i aeroportit merr masat e nevojshme për të ndarë fizikisht lëvizjen e pasagjerëve në fluturimet e brendshme nga ajo e



pasagjerëve në udhëtimet që janë subjekt i verifikimit kufitar si dhe për të parandaluar hyrjen e daljen e personave të paaautorizuar nga zonat e rezervuara, si zona e transitit apo zonat me status të ngjashëm, duke ngritur infrastrukturën e nevojshme për këtë qëllim, përkatësisht, në secilin aeroport ndërkombëtar.

h) Ndarja fizike e lëvizjes së udhëtarëve të linjave të brendshme nga ato të jashtme, sipas parashikimit të shkronjës “g”, nuk është e detyrueshme në rastin e aerodromeve. Edhe në këtë rast operatori merr masat e nevojshme që verifikimi kufitar të kryhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, duke kanalizuar lëvizjet e udhëtarëve në zonat, hapësirat dhe drejtimit përkatëse.

i) Në rastet kur një mjet i qarkullimit ajror, për rrjedhojë të forcës madhore, të një rreziku të çastit, të një udhëzimi të autoriteteve përgjegjëse, të një uljeje pa leje, ulet në një pikë që nuk është pikë e kalimit kufitar, mund ta vijoje fluturimin vetëm pas autorizimit nga rojet kufitare dhe autoritetet përgjegjëse të doganave.

j) Hyrja dhe dalja e deltaplanëve, avionëve mikro të lehtë, helikopterëve, avionëve të vegjël që fluturojnë vetëm në distanca të afërta dhe aerostatëve rregullohen me akte të përbashkëta të ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Financave dhe sipas llojit të fluturimit, me ministrat përkatës, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

k) Pavarësisht se verifikimi kufitar i udhëtarëve të linjave të rregullta të avionit kryhet në ambientet përkatëse të verifikimit kufitar, operatori që kryen transportin ndërkombëtar të udhëtarëve ka detyrimin që para nisjes të komunikojë paraprakisht tek autoritetet përgjegjëse listën e udhëtarëve në bord.

13. Mjetet e lundrimit

a) Verifikimet e personave në anije kryhen në portin e mbërritjes apo të nisjes ose në një zonë të caktuar për atë qëllim, e cila gjendet në afërsi të anijes ose në bord të anijes, në ujërat e Republikës së Shqipërisë, sipas detyrimeve që rrjedhin nga konventa e OKB-së “Për të drejtën e detit”.

b) Kur kjo parashikohet në një marrëveshje të veçantë, verifikimet mund të kryhen edhe gjatë udhëtimit ose me mbërritjen apo me nisjen e anijes në territorin e një vendi tjetër, duke respektuar parashikimet e ligjit nr. 71/2016, “Për

kontrollin kufitar”, dhe të këtij vendimi, për sa u përket verifikimeve kufitare.

c) Kapiteni, agjenti i anijes, çdo person tjetër i autorizuar zyrtarisht nga kapiteni ose përfaqësuesi juridik i anijes, që në vijim referohet me termin “kapiteni”, harton listën e ekuipazhit e të pasagjerëve, e cila përmban informacionin e kërkuar në formularët 5 (lista e ekuipazhit) dhe 6 (lista e pasagjerëve) të Konventës për Lehtësimin e Trafikut Detar Ndërkombëtar (Konventa FAL), si dhe aty ku gjen zbatim, numrat e vizave ose lejeve të qëndrimit.

ç) Në rastet e hyrjes, kapiteni u komunikon listën e parashikuar në shkronjën “c” rojeve kufitare ose, në pamundësi të kësaj, autoriteteve të kapitenerisë së portit përkatës, sipas këtyre afateve:

i) Jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë para mbërritjes në port, për udhëtimet që zgjasin mbi 24 (njëzet e katër) orë;

ii) Jo më vonë se koha e nisjes nga porti i mëparshëm, për udhëtimet që zgjasin më pak se 24 (njëzet e katër) orë;

iii) Sa më shpejt nga koha që saktësohet informacioni mbi portin destinacion, për udhëtimet që nuk është i ditur itinerari ose itinerari i të cilave ndryshon gjatë udhëtimit.

d) Kapiteni njofton autoritetin kompetent menjëherë dhe në përputhje me afatet e parashikuara në shkronjën “ç” për ndryshimet në përbërjen e ekuipazhit ose të pasagjerëve si dhe për praninë në bord të udhëtarëve të paaautorizuar, të cilët, pavarësisht nga rrethanat, janë përgjegjësi e kapitenit.

dh) Kapitenit të anijes i ndalohet të marrë ose të zbresë në ujërat e brendshme dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë persona, të cilët nuk i janë nënshtruar verifikimit në pikën e kalimit kufitar, me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndihmë për shkak të forcës madhore.

e) Kapiteni i mjetit lundrues nuk lejohet të akostojë, të marrë ose të zbresë persona, qofshin këta me dokumentet përkatëse, jashtë vendeve që janë pikë kalimi kufitar ose jashtë zonave të lejuara nga Policia Kufitare dhe e Migracionit për akostim.

ë) Kapiteni i anijes njofton menjëherë Policinë Kufitare dhe të Migracionit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet kapitenerisë së portit kur, për arsye të forcës madhore, anija akostohet jashtë zonës së verifikimit kufitar.



f) Konfirmimi i marrjes së listës në hyrje nga autoritetet përgjegjëse, qoftë ky shkresor ose elektronik, i dorëzohet/përcillet kapitenit, në bazë të kërkesës së këtij të fundit, jo më vonë sesa koha kur anija ka mbërritur në port.

g) Një kopje e listave të vulosura/të konfirmuara nga Policia Kufitare dhe e Migracionit i kthehet kapitenit të anijes, i cili e tregon atë sa herë që i kërkohet në port ose në raste të tjera kur kërkohet nga rojet kufitare për efekt të verifikimit kufitar.

gj) Kapiteni dhe personat e punësuar në bord, që përfshihen në listën e ekuipazhit, dhe anëtarët e familjes së tyre, të cilët jetojnë në bord të mjeteve lundruese që përdoren për qëllime sipërmarrjeje, konsiderohen si anëtarë ekuipazhi ose të barasvlershëm me ta.

h) Ekuipazhi dhe udhëtarët e anijes shqiptare apo të huaj lejohen të zbresin në tokë vetëm pas përfundimit të procedurave të verifikimit kufitar.

i) Marinarët e huaj, të cilët janë pjesë e ekuipazhit të anijeve që mbajnë flamur të huaj, mund të zbresin në portin e ankorimit ose të bëjnë vizita në territorin e bashkive respektive apo në zonat në afërsi, me kërkesën e kapitenit të anijes dhe duke u pajisur në pikën e kalimit kufitar me leje kalimi individuale, në të cilën përcaktohen kohëzgjatja dhe vlefshmëria territoriale.

j) Në rastin e largimit, kapiteni njofton gjithashtu rojet kufitare në portin përkatës, në kohën e duhur dhe sipas rregullave në fuqi për nisjen e anijes, duke depozituar listën e ekuipazhit. Kopja e dytë e listës së plotësuar dhe të vulosur më parë i kthehet policisë kufitare ose autoriteteve të kapitenerisë.

k) Pjesëtarët e ekuipazheve të trageteve trajtohen në të njëjtën mënyrë si pjesëtarët e ekuipazheve të anijeve tregtare.

l) Përfshihet nga rregullat e parashikuara për listat në shkronjat “c” dhe “ç”, të kësaj pike, formati i listës së udhëtarëve dhe rregullat specifike për transmetimin e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit të Punëve të Brendshme.

ll) Pasagjerët e trageteve të linjave të rregullta të jashtme, të cilat janë subjekt i verifikimit kufitar, i nënshtrohen verifikimeve kufitare, si më poshtë vijon:

i) Në korsi të veçanta për udhëtarët e trageteve të linjave të rregullta, ku ekziston mundësia fizike për përshtatjen e këtyre korsive;

ii) Në korsi individuale për pasagjerët këmbësorë;

iii) Sipas parashikimeve për mjetet e qarkullimit rrugor, për pasagjerët e automjeteve.

m) Kur trageti hyn nga një linjë e jashtme që është subjekt i verifikimit kufitar dhe ka më shumë se një ndalesë në portet e brendshme, pasagjerët që imbarkojnë dhe zbarkojnë në linjat e brendshme i nënshtrohen një verifikimi kufitar në portin ku imbarkohen dhe një verifikimi kufitar në portin ku zbarkohen, pavarësisht se nuk kryejnë kalim të kufirit, ndërsa personat që qëndrojnë në bord të tragetit i nënshtrohen verifikimit kufitar në portin e fundit të mbërritjes.

n) Në dalje, verifikimet e personave në tragete kryhen anasjelltas me rregullat e parashikuara për hyrjen.

nj) Kapiteni i anijes kruazierë i përcjell rojeve kufitare ose autoritetit të kapitenerisë itinerarin dhe programin e udhëtimit menjëherë sapo ato të jenë përcaktuar dhe jo më vonë se afati i parashikuar në shkronjën “ç” për anijet tregtare.

o) Në rastin kur itinerari i një anijeje kruazierë përfshin lëvizje të jashtme, që janë objekt i verifikimeve kufitare, verifikimet kryhen, si më poshtë vijon:

i) Kur anija kruazierë mbërrin për herë të parë nga një port i jashtëm në një port që gjendet në territor ose niset nga një port i brendshëm drejt një porti të jashtëm, ekuipazhi dhe pasagjerët u nënshtrohen verifikimeve kufitare në hyrje dhe dalje në bazë të listave emërore të ekuipazhit dhe të pasagjerëve, të parashikuara në shkronjën “c”;

ii) Kur itinerari i anijes kruazierë përfshin ndërthurazi lëvizje të brendshme dhe të jashtme, ekuipazhi dhe pasagjerët u nënshtrohen verifikimeve në hyrje në bazë të listave emërore të ekuipazhit e të pasagjerëve, të parashikuara në shkronjën “c”, në përputhje me ndryshimet që mund t’u jenë bërë listave që prej momentit kur anija kruazierë ka vizituar portin e mëparshëm që gjendet në territor;

iii) Gjatë sekuencave të itinerarit, ku anija kruazierë lëviz vetëm midis porteve të brendshme, nuk kryhen verifikime kufitare në hyrje apo dalje;

iv) Pasagjerët, që zbresin në breg, sipas rasteve në nënndarjet “i” dhe “ii”, u nënshtrohen verifikimeve kufitare individuale nëse vlerësimi i rreziqeve që lidhen me sigurinë e brendshme dhe



migracionin e paligjshëm tregon se verifikime të tilla janë të nevojshme.

p) Mjetet lundruese për argëtim paraqesin pranë Policisë Kufitare dhe të Migracionit kërkesën me shkrim për lundrim, ku përfshihet lista e personave në bord, rajoni i lundrimit dhe koha e qëndrimit, së bashku me dokumentin që përmban karakteristikat teknike të mjetit.

q) Dokumentacioni i parashikuar në shkronjën “p” përfshihet te dokumentacioni i mjetit lundrues, për sa kohë mjeti qëndron në ujërat e Republikës së Shqipërisë, ndërsa një kopje e tij u dorëzohet autoriteteve të Policisë Kufitare dhe Migracionit në portin e mbërritjes dhe atë të nisjes.

r) Kapiteni i mjetit lundrues, që përdoret për peshkim profesional, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë para fillimit të gjetisë apo peshkimit, njofton me shkrim Policinë Kufitare dhe të Migracionit për kryerjen e këtij aktiviteti individual ose në grup, në një distancë deri në 300 (treqind) metra nga bregu.

rr) Ekuipazhet e anijeve të peshkimit bregdetar, që janë të regjistruara në një port të huaj dhe që janë subjekt i verifikimit kufitar, verifikohen në përputhje me dispozitat për detarët.

s) Përveç rasteve të forcës madhore, mund të akostojnë në porte që nuk janë pika kalimi kufitar mjetet lundruese në vijim:

i) Anijet kruazierë, itinerari i të cilave përfshin vetëm porte të brendshme;

ii) Mjetet për lundrim argëtues, të cilat kryejnë vetëm lëvizje të brendshme;

iii) Mjetet për lundrim argëtues që vijnë nga një port i huaj dhe janë subjekt i verifikimit kufitar, në raste të veçanta të përcaktuara në një marrëveshje apo në një vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

sh) Si rregull, kryhen verifikime kufitare me përzgjedhje dhe josistematike, ndaj:

i) personave që qëndrojnë në bord të anijes pa pasur synim të zbresin në port;

ii) ekuipazheve të mjeteve lundruese të peshkimit bregdetar që kthehen çdo ditë ose maksimalisht brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) orësh në portin e regjistrimit ose në çdo lloj porti tjetër që gjendet në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa akostuar në porte të jashtme.

t) Si rregull, nuk janë subjekt i verifikimit kufitar:

i) personat në bordin e anijeve kruazierë, itinerari i të cilave përfshin vetëm porte të brendshme;

ii) personat në bord të mjeteve për lundrim argëtues, të cilat kryejnë vetëm lëvizje të brendshme;

iii) personat në bord të mjeteve të lundrimit në linjat e brendshme detare të ngarkesave që konsistojnë në transport mallrash.

th) Në rastet e veprimtarive sportive ndërkombëtare, kalimi transit i mjeteve lundruese kryhet pasi është kërkuar paraprakisht leje nga Policia Kufitare dhe e Migracionit për sa i përket kohës, numrit të mjeteve dhe itinerarit të lëvizjes.

u) Mjetet lundruese pajisen nga institucionet përgjegjëse me leje për ushtrimin e veprimtarive turistike, sportive, studimore, kërkimore-shkencore dhe veprimtarive të tjera të ngjashme dhe lundrojnë në ujërat e brendshme apo ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë me dijeninë dhe me miratimin e Policisë Kufitare dhe të Migracionit, pasi i janë nënshtruar më parë verifikimit kufitar, kur kryejnë lëvizje ndërkufitare.

v) Dispozitat për verifikimin kufitar të mjeteve lundruese në qarkullimin detar zbatohen, së bashku me ndryshimet përkatëse (*mutatis mutandis*) për verifikimet kufitare ndaj mjeteve që kryejnë lundrim në rrugët e brendshme ujore, ku përfshihet lundrimi për qëllime sipërmarrjeje apo turizmi i të gjitha llojeve të mjeteve lundruese në lumenj, kanale dhe liqene.

x) Për t'u siguruar që verifikimet kufitare të kryhen shpejt, operatori i portit siguron një numër të përshtatshëm korsish, portash dhe kabinash.

xh) Autoritetet e kapitenerisë së porteve njoftojnë pa vonesë rojet kufitare të pikës portuale të kalimit kufitar që ka juridiksionin territorial për njoftimet që marrin nga mjetet lundruese në të gjitha rastet kur kapiteni nuk ka mundësinë e njoftimit të drejtpërdrejtë të rojeve kufitare dhe në të gjitha rastet që evidentohet prania e panjoftuar e një mjeti lundrues në portin që këto autoritete kapitenerie administrojnë si dhe u vendosin në dispozicion rojeve kufitare listat e ekuipazhit e të pasagjerëve që janë depozituar tek ta nga mjeti lundrues.

y) Pavarësisht nga përjashtimet e parashikuara në pikën 13, të këtij vendimi, për të gjitha llojet e mjeteve lundruese, bazuar në analizën dhe vlerësimin e risqeve, në informacionet dhe



dysimet e mbështetura që lidhen me sigurinë e brendshme dhe migracionin e paligjshëm, rojet kufitare kryejnë verifikime kufitare individuale ndaj pasagjerëve dhe anëtarëve të ekuipazhit si dhe inspektive fizike ndaj mjeteve të lundrimit e mjeteve e sendeve që mund të transportohen në to, në çfarëdo vendi ku mjeti lundruar ka akostuar dhe në çfarëdo zone në ujërat e brendshme apo ujërat territoriale ku mjeti lundruar gjendet.

KREU III

INSTITUCIONET E NGARKUARA PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

14. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 807, datë 16.11.2016

PËR DISIPLINIMIN E ANGAZHIMEVE BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 16, 40 dhe 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.

2. Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve

publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës.

3. Kufizimit kohor të parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, nuk i nënshtrohen:

a) fondet e akorduara nëpërmjet rishikimit të ligjit vjetor të buxhetit;

b) fondet e akorduara me vendim të Këshillit të Ministrave nga fondi rezervë dhe/ose fondi i kontingjencës, për raste emergjente/të paparashikuara;

c) fondet e akorduara me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve;

ç) fondet e rialokuara për kryerjen e një investimi/shërbimi, në zbatim të detyrimeve të parashikuara me ligj të ri;

d) prokurimet për shërbimin e ushqimit dhe /ose të medikamenteve, në ato njësi të qeverisjes së përgjithshme që i administrojnë këto shërbime;

dh) prokurimet me vlerë të vogël, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në rastet kur, fondet buxhetore për to janë të parashikuara në buxhetin e vitit korrent të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe janë pjesë e regjistrit të prokurimeve publike.

4. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësisë të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 808, datë 16.11.2016

PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË KONCESIONIT PËR RAFINERI SHOQËRISË AKSIONARE “RBH BELINE”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të



vendimit nr. 19, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e licencës së koncesionit për rafineri shoqërisë aksionare “RBH Beline”, me NIPT L22524401A dhe seli në Balldren, Elbasan, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LICENCË KONCESIONI PËR RAFINERI

Nr. 4773/7, datë 8.11.2016

Në mbështetje të nenit 12, pika 2, dhe nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 19, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, shoqëria aksionare “RBH Beline” është pajisur me miratim paraprak nr. 4812/2, datë 15.9.2014, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

I jepet shoqërisë aksionare “RBH Beline”, me NIPT L22524401A dhe seli në Balldren, Elbasan, Licenca e Koncesionit për Rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto dhe për prodhimin e nënprodukteve të saj.

a) Emri dhe selia e personit juridik:

Shoqëria aksionare “RBH Beline”, me seli në Balldren, Elbasan. Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, datë 24.1.2012, me NIPT: L22524401A.

b) Koordinatat dhe vendndodhja e rafinerisë;

Nr.	Koordinatat gjeodezike	
	X	Y
1	X=4416533.50	Y=4550728.315
2	X=4416457.256	Y=4550766.496
3	X=4416663.558	Y=4550669.893
4	X=4416621.833	Y=455.631.713

c) Numri dhe data e vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndërtimit/zhvillimit:

- “Leje zhvillimore komplekse” me vendim nr. 2, datë 29.12.2014, objekti: “Rafineri për prodhim bitumi dhe nënprodukte të naftës”, nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

ç) Lloji i licencës së tregtimit dhe afati i saj, nëse personi juridik është pajisur me këtë licencë;

Licencë tregtimi me shumicë nr. LN- 6195-02-213, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

Prodhim, depozitim, transport, përdorim dhe/ose tregtim i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera të rrezikshme.

Afati i vlefshmërisë së kësaj licence është pa afat.

d) Afati i vlefshmërisë së licencës së koncesionit; 30 vjet me të drejtë përsëritjeje, pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave.

E drejta për rinovimin e kësaj licence bëhet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në kreun V, të VKM-së nr. 19, datë 14.1.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”.

dh) Afati i përfundimit të ndërtimit të rafinerisë, afati i vënies në përdorim, si dhe rastet kur do të lejohet shtyrja e afatit të ndërtimit apo vënies në përdorim.

Objekti ka përfunduar ndërtimin në bazë të lejes së ndërtimit dhe është pajisur me leje përdorimi nr. 1116/4 prot., datë 5.8.2016, nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Afati i vënies në përdorim është 31.12.2016.

e) E drejta e organeve dhe institucioneve shtetërore, të ngarkuara me ligj, për kontrollin e zbatimit të projektit sipas kushteve dhe afatit të përcaktuar në projekt.

ë) Këshilli i Ministrave ka të drejtë revokimin e kësaj licence kur nga kontrollet e ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, konstatohet dështimi i përmbushjes së kërkesave të licencës së koncesionit për rafineri, në zbatimin e parametrave teknikë, në afatin e



realizimit të projektit dhe të normave mjedisore;

f) Kapaciteti dhe kategoria e produkteve që do të prodhojë rafineria.

Kapaciteti i përpunimit të naftës bruto është 600 tonë/24 orë.

Produktet që do të prodhojë rafineria janë të përshkruara në kartën teknologjike të lëshuar nga ISHTI-ja, bashkëlidhur licencës, e cila është pjesë e integruar e saj.

g) Shoqëria aksionare “RBH Beline”, pas miratimit të kësaj licence koncesioni duhet të paguajë tarifën e licencimit sipas legjislacionit në fuqi. Licenca e koncesionit është e vlefshme vetëm pas pagesës së tarifës së licencimit.

gj) Shoqëria aksionare “RBH Beline” pas miratimit të kësaj licence koncesioni, në zbatim të kërkesave të nenit 9, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, ka detyrim mbajtjen e rezervës së sigurisë, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara këtu.

h) Shoqëria aksionare “RBH Beline” pas miratimit të kësaj licence koncesioni duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, informacionet dhe të dhënat përkatëse, brenda afateve, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

i) Shoqëria aksionare “RBH Beline” në rastin e ndryshimeve në skemën dhe kartën teknologjike të funksionimit të rafinerisë, si dhe për markën e cilësinë e nënprodukteve të naftës të prodhuara nga rafineria, duhet të zbatojë përcaktimet e nenit 12, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

Kjo licencë koncesioni për rafineri do të udhëhiqet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim, pretendim ose ndryshim opinioni, që lind nga/ose në lidhje me këtë licencë koncesioni, do të trajtohet nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

MINISTRI I ENERGIJË
DHE INDUSTRIJË
Damian Gjoknuri

VENDIM

Nr. 809, datë 16.11.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ZBATIMIN E KODIT NDËRKOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË SIGURISË (ISM CODE)”¹

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 401, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9213, datë 1.4.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1947”, të ndryshuar, dhe në protokollin e kësaj konvente, të vitit 1978, të ndryshuar”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)”, sipas tekstit dhe shtojcave që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për transportin që, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatimin të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 10, të rregullore.

3. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Ky vendim i Këshillit të Ministrave përaftron plotësisht rregulloren 336/2006, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 15 shkurt 2006, mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë brenda Komunitetit dhe shfuqizimin e Rregullore së Këshillit (KE) No. 3051/95, botuar në Fletoren Zyrtare L 64/1, datë 4.3.2006, faqe 1–36, me CELEX 32006R0336 dhe 540/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 16 June 2008, për amendimin e aneksit II të kësaj rregulloreje, botuar në Fletoren Zyrtare L 157/15, datë 17.6.2008, faqe 15–22 me CELEX 32008R0540.



RREGULLORE
PËR ZBATIMIN E KODIT
NDËRKOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË
SIGURISË (ISM CODE)

KAPITULLI I
PARIMET KRYESORE

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregullore është lehtësimi i zbatimit në Shqipëri të Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit për Lundrimin e Sigurt të Anijeve dhe Parandalimin e Ndotjes, miratuar nga Organizata Detare Ndërkombëtare, nëpërmjet:

a) rritjes së menaxhimit të sigurisë dhe lundrimit të sigurt të anijeve si dhe parandalimin e ndotjes nga anijet, duke siguruar që kompanitë që drejtojnë këto anije të veprojnë në përputhje me Kodin ISM, nëpërmjet përcaktimit, zbatimit dhe mirëmbajtjes, nga kompanitë, të sistemeve të menaxhimit të sigurisë në bordet e anijeve dhe në ato të vendosura në breg;

b) kontrollit, nga sektorët e Kontrollit Shtetëror Portual dhe Kontrollit Shtetëror të Flamurit.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Anije mallrash”, anija që përfshin mjetet lundruese me shpejtësi të lartë, e cila nuk është anije pasagjerësh;

b) “Anije pasagjerësh”, anija që përfshin mjetet lundruese me shpejtësi të lartë, e cila mbart më shumë se 12 pasagjerë apo mjet lundrues nënujor për pasagjerë;

c) “Anijet traget (Ro-Ro) pasagjerësh”, një anije detare pasagjerësh, siç përcaktohet në kapitullin II-1 të SOLAS, në versionin e tij të azhurnuar (në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9213, datë 1.4.2004);

ç) “Kodi ISM”, Kodi Ndërkombëtar i Menaxhimit për Funksonimin e Sigurt të Anijeve dhe Parandalimin e Ndotjes, miratuar nga Organizata Detare Ndërkombëtare, nga Rezoluta e Asamblesë A.741(18), datë 4 nëntor 1993, amenduar nga Rezoluta e Komitetit Detar të Sigurisë MSC.104(73), datë 5 dhjetor 2000, dhe përcaktuar në aneksin I, të kësaj rregulloreje, në

versionin e saj të përditësuar;

d) “Kompani”, zotëruesi i anijes ose çdo organ apo person tjetër, i tillë si menaxheri ose qiramarrësi, i cili ka marrë nga zotëruesi përgjegjësinë për funksionimin e anijes dhe, me marrjen e një përgjegjësie të tillë, ka rënë dakord të marrë përsipër të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara nga Kodi ISM;

dh) “Lundrim ndërkombëtar”, lundrimi nga deti, nga një port i Shqipërisë në një port të huaj, ose udhëtimi nga deti, nga një shtet tjetër në një port jashtë këtij shteti, apo anasjelltas;

e) “Lundrim kombëtar”, udhëtimi nga deti, nga një port në të njëjtin port apo në një port tjetër brenda Shqipërisë;

ë) “Mjet lundrues me shpejtësi të lartë”, një mjet lundrues me shpejtësi të lartë, siç përcaktohet në rregulloren X-1/2 të Konventës SOLAS, në versionin e saj të azhurnuar (në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9213, datë 1.4.2004);

f) “Mjet lundrues nënujor për pasagjerë”, një anije e lëvizshme, që mbart pasagjerë, e cila, kryesisht, lundron nën ujë dhe mbështetet në pajisje të tilla, si anije lundruese apo mjete të vendosura në breg për monitorimin dhe për një ose më shumë nga pikat e mëposhtme:

i) furnizimin me energji;

ii) furnizimin me ajër të presionit të lartë;

iii) furnizimin me pajisje dhe mjete jetese.

g) “Njësi e lëvizshme e shpim-kërkimit në det të hapur”, anija që angazhohet në operacione të shpim-kërkimit për eksplorimin ose shfrytëzimin e resurseve nën shtratin e detit, të tilla si hidrokarbure të lëngshme apo të gazta, sulfur apo kripë;

gj) “Organizatë e njohur”, një shoqëri e autorizuar nga qeveria shqiptare për implementimin, auditimin dhe lëshimin e certifikatave sipas kodit ISM;

h) “Pasagjer”, çdo person përveç:

i) kapitenit dhe anëtarëve të ekuipazhit apo personave të tjerë të punësuar ose të angazhuar në ndonjë funksion në bordin e anijes, lidhur me biznesin e kësaj anijeje;

ii) fëmijës nën moshën një vjeç.

i) “Shërbim i rregullt i transportit detar”, një seri kalimesh të anijes, në mënyrë të tillë që t’i shërbejnë trafikut ndërmjet dy a më shumë pikave të njëjta, ose:



i) në përputhje me orarin e publikuar;
ii) me kalime të rregullta apo të shpeshta, në mënyrë të tillë që të përbëjnë një seri sistematike të njohur.

j) “Tonazh bruto”, tonazhi bruto i anijes, përcaktuar në përputhje me Konventën Ndërkombëtare për Përmasat e Tonazhit të Anijeve, 1969 (në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 8989, datë 23.1.2003), ose, në rastin e anijeve të angazhuara ekskluzivisht në udhëtime vendase dhe jo të matura në përputhje me konventën e mësipërme, tonazhi bruto i anijes, përcaktuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 3

Fusha e veprimit

1. Kjo rregullore zbatohet për llojet e anijeve dhe për kompanitë që i përdorin ato, si më poshtë vijon:

a) Anije mallrash dhe anije pasagjerësh që janë regjistruar në Shqipëri, të angazhuara në udhëtime ndërkombëtare;

b) Anije mallrash dhe anije pasagjerësh të angazhuara ekskluzivisht në transport të brendshëm, pavarësisht nga shteti ku janë regjistruar;

c) Anije mallrash dhe anije pasagjerësh që lundrojnë në drejtim të apo nga portet e Shqipërisë, që kryejnë shërbime të rregullta transporti, pavarësisht nga shteti ku janë regjistruar;

ç) Njësitë e lëvizshme të shpim-kërkimit në det të hapur, që funksionojnë nën autoritetin e Shqipërisë.

2. Kjo rregullore nuk gjen zbatim për llojet e anijeve apo për kompanitë që i përdorin ato, si më poshtë vijon:

a) Anijet e luftës dhe anijet e transportit për trupa, si dhe anije të tjera, të zotëruara apo të përdorura nga Shqipëria vetëm për shërbime jotregtare qeveritare;

b) Anijet që nuk shtyhen nga mjete mekanike, anije prej druri, të ndërtuara në mënyrë primitive, jahtet turistike dhe mjetet lundruese sportive, në qoftë se nuk kanë ekuipazh dhe nuk mbartin më shumë se 12 pasagjerë, për qëllime tregtare;

c) Anijet e peshkimit;

ç) Anijet e mallrave dhe njësitë e lëvizshme të shpim-kërkimit në det të hapur, me tonazh bruto më pak se 500 t;

d) Anijet e pasagjerëve, të ndryshme nga anijet traget të pasagjerëve, të angazhuara në transport kombëtar, gjatë të cilave ato, asnjëherë, nuk lundrojnë më larg se 15 milje larg një vendstrehimi, jo më shumë se 5 milje nga vija e bregut, ku mund të zbarkojnë personat e anijes së fundosur, në përputhje me lartësinë mesatare të baticës.

Neni 4

Kompetenca

Administrata detare, ose organizata e njohur prej saj, është institucioni kombëtar me kompetencën për të siguruar se të gjitha kompanitë që përdorin mjete lundruese, që përfshihen në objektin e kësaj rregulloreje, veprojnë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Kërkesat e menaxhimit të sigurisë

1. Anijet e referuara në pikën 1, të nenit 3, dhe kompanitë që i operojnë ato janë në përputhje me kërkesat e pjesës A, të Kodit ISM.

2. Për qëllimet e certifikimit dhe verifikimit, janë të detyrueshme dispozitat e pjesës B, të Kodit ISM.

Neni 6

Certifikimi dhe verifikimi

Për qëllime të certifikimit dhe të verifikimit, administrata detare, organizata e njohur prej saj dhe çdo kompani detare, për çdo anije të zotëruar prej saj, duhet të marrë masat e nevojshme që të veprojnë në zbatim të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të pjesës B, të aneksit I.

KAPITULLI II

DETYRIMET E KOMPANISË

Neni 7

Përdorimi i certifikatave

1. Asnjë kompani nuk duhet të përdorë një mjet lundrues në qoftë se kjo kompani nuk ka dokumentin e vlefshëm të përputhshmërisë, sipas aneksit të kësaj rregulloreje.

2. Asnjë kompani nuk duhet të përdorë një mjet lundrues, në qoftë se nuk ka një certifikatë të vlefshme për menaxhimin e sigurisë për këtë anije.

3. Asnjë anije shqiptare nuk do të operojë në qoftë se:



a) kompania nuk ka një dokument të përputhshmërisë, të lëshuar ose të pranuar nga administrata detare ose një organizatë e njohur;

b) nuk ka një certifikatë të menaxhimit të sigurisë, të lëshuar apo të pranuar nga administrata detare apo një organizatë e njohur.

4. Për qëllime të kësaj rregulloreje, nuk është i vlefshëm dokumenti i përputhshmërisë apo certifikata e menaxhimit të sigurisë nëse nuk është miratuar në rrethanat e kërkuara nga Kodi ISM, që tregojnë kontrolle vjetore kompetente, në rastin e dokumentit të përputhshmërisë ose kontrolle të ndërmjetme kompetente, në rastin e certifikatës së menaxhimit të sigurisë.

Neni 8

Detyrimi për të mbajtur certifikatat

Çdo kompani ka për detyrë të sigurojë që në bordin e çdo anijeje, për të cilën zbatohet kjo rregullore, të mbahet certifikata e vlefshme e menaxhimit të sigurisë dhe një kopje e dokumentit të përputhshmërisë.

Neni 9

Detyra e kapitenit

Kapiteni i çdo anijeje duhet të drejtojë anijen e tij në përputhje me sistemin e menaxhimit të sigurisë, mbi bazën e të cilit është lëshuar certifikata e menaxhimit të sigurisë.

Neni 10

Personi i caktuar

1. Kompania cakton një person, i cili është përgjegjës për të monitoruar funksionimin e sigurt dhe efikas të çdo anijeje, duke i kushtuar rëndësi të veçantë aspekteve të sigurisë dhe parandalimit të ndotjes.

2. Në veçanti, personi i caktuar, duhet të:

a) marrë masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me sistemin e menaxhimit të sigurisë të kompanisë, mbi bazën e të cilit është lëshuar dokumenti i përputhshmërisë;

b) sigurojë që çdo anije të pajiset me ekuipazh, me pajisje dhe të mirëmbahet në mënyrë të tillë, që të jetë e përshtatshme për të operuar në përputhje me sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe me kërkesat ligjore.

3. Kompania duhet të sigurojë që personi i caktuar të ketë:

a) autoritetin dhe burimet e mjaftueshme;

b) njohuritë e duhura për aktet ligjore e nënligjore përkatëse dhe përvojën e mjaftueshme për funksionimin e sigurt të anijeve në det dhe në port, në zbatim të pikës 6, të aneksit I, duke i krijuar të gjitha mundësitë për të vepruar në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni. Udhëzimi për kualifikimet, trajnimet dhe eksperiencën e nevojshme që duhet të ketë personi i caktuar për të ndërmarrë rolin, sipas dispozitave të Kodit ISM, miratohet nga ministri, pas propozimit nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

KAPITULLI III

DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATËS

Neni 11

Derogimi

1. Administrata detare ose organizata e njohur, nëse vlerëson në praktikë se është e vështirë për kompanitë të veprojnë në përputhje me pikat 6, 7, 9, 11 dhe 12, të pjesës A, të aneksit I (Kodi ISM), për anije të caktuara apo kategori të caktuara anijesh ekskluzivisht të angazhuara në udhëtime të brendshme në Shqipëri, mund të derogojë tërësisht ose pjesërisht nga dispozitat përkatëse, duke caktuar masa që sigurojnë arritje ekuivalente të objektivave të Kodit.

2. Administrata detare, për anijet dhe kompanitë për të cilat është miratuar derogimi sipas pikës 1, nëse ajo vlerëson në praktikë se janë të vështira për të zbatuar kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 5, mund të përcaktojë procedurat alternative të certifikimit dhe të verifikimit.

3. Pas derogimit, sipas pikës 1 dhe, nëse zbatohet, sipas pikës 2, administrata detare ose organizata e njohur lëshon një certifikatë, në përputhje me nënparagrafin e dytë, të aneksit II, pjesa B, seksioni 5, që tregon kufijtë e zbatueshëm.

Neni 12

Vlefshmëria, pranimi dhe njohja e certifikatave

1. Dokumenti i përputhshmërisë është i vlefshëm deri në pesë vjet, nga data e lëshimit të tij. Certifikata e menaxhimit të sigurisë është e vlefshme deri në pesë vjet, nga data e lëshimit të saj.

2. Në rastin e rinovimit të dokumentit të përputhshmërisë dhe certifikatës së menaxhimit të



sigurisë zbatohen dispozitat përkatëse të pjesës B, të Kodit ISM.

3. Administrata detare ose organizata e njohur pranon dokumentet e përputhshmërisë, dokumentet e përkohshme të përputhshmërisë, certifikatat e menaxhimit të sigurisë dhe certifikatat e përkohshme të sigurisë të lëshuara nga administrata e çdo shteti tjetër, në emër të kësaj administrate, nga një organizatë e njohur.

4. Administrata detare ose organizata e njohur pranon dokumentet e përputhshmërisë, dokumentet e përkohshme të përputhshmërisë, certifikatat e menaxhimit të sigurisë dhe certifikatat e përkohshme të menaxhimit të sigurisë të lëshuara nga ose për llogari të administratës së një shteti tjetër, të tretë.

Gjithsesi, për anijet që ushtrojnë aktivitetin në një shërbim të rregullt lundrues, në përputhje me Kodin ISM, si dokumentet e përputhshmërisë, dokumentet e përkohshme të përputhshmërisë, certifikatat e menaxhimit të sigurisë dhe certifikatat e përkohshme të menaxhimit të sigurisë, të lëshuara për llogari të administratës së një shteti tjetër, të tretë, do të verifikohen me çdo mënyrë të përshtatshme, nga ose për llogari të administratës, vetëm nëse ato janë lëshuar nga administrata e një shteti anëtar ose nga një organizatë e njohur.

Neni 13

Pezullimi ose anulimi i dokumenteve të përputhshmërisë dhe certifikatave të menaxhimit të sigurisë

1. Administrata detare mund të pezullojë ose anulojë çdo dokument të përputhshmërisë apo certifikatë të menaxhimit të sigurisë të lëshuar për një anije shqiptare, në qoftë se:

a) certifikata është lëshuar mbi bazën e informacionit të rremë ose të gabuar;

b) që nga kontrolli në zbatim të kësaj rregulloreje struktura e menaxhimit e kompanisë ose anijes ka ndryshuar në mënyrë thelbësore;

c) kontrolli i kompanisë ose anijes ka zbuluar moszbatim, në përputhje me nenin 6.

2. Dokumenti i përputhshmërisë ose certifikata e menaxhimit të sigurisë e pezulluar apo e anuluar nënkupton pezullimin e funksionimit të anijes.

Neni 14

Standardet e zbatimit

Në kryerjen e detyrave të verifikimit dhe certifikimit, sipas dispozitave të Kodit ISM, për anijet që i përkasin objektit të kësaj rregulloreje, administrata detare ose organizata e njohur vepron në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në aneksin II dhe, përveç kësaj, merr parasysh dispozitat e udhëzimeve të rishikuara për zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM) nga administratat përkatëse, miratuar nga IMO, për sa kohë nuk mbulohen nga pjesa B, e aneksit II.

Neni 15

Udhëzime për inspektorët

Udhëzimet për inspektorët dheurvejorët që kontrollojnë sistemet e menaxhimit të sigurisë së anijeve në det, si edhe në breg, jepen nga administrata detare. Këto udhëzime do të shërbejnë për zotëruesit e anijeve, operatorët dhe persona të tjerë të interesuar për procedurat e miratuara në lidhje me kryerjen e kontrolleve për përputhjen me Kodin ISM.

KAPITULLI IV

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Çdo shkelje e neneve 6 ose 7, nga një kompani, do të konsiderohet si kundërvajtje dhe do të ndëshkohet në zbatim të nenit 381, të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

2. Për çdo shkelje të nenit 8, kompania do të ndëshkohet sipas nenit 394, të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

3. Çdo shkelje e nenit 9, nga kapiteni i anijes, përbën kundërvajtje dhe ndëshkohet sipas nenit 387, të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

4. Për çdo shkelje e nenit 10, kompania do të ndëshkohet sipas nenit 394, të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë, ndërsa, për personin e caktuar, përbën kundërvajtje dhe dënohet sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 394, të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.



Neni 17 Ankimimi

Kundër dënimit me gjobë, subjekti kundërvajtës mund të bëjë ankim administrativ te ministria përgjegjëse për transportin. Ministria përgjegjëse për transportin, për trajtimin e ankesës, vepron në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 18 Afati i vlefshmërisë së dokumentacionit

Dokumentet e përkohshme të përputhshmërisë, certifikatat e përkohshme të menaxhimit të sigurisë, të lëshuara përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, janë të vlefshme deri në skadimin e tyre apo deri në miratimin tjetër.

ANEKSI I KODI NDËRKOMBËTAR I MENAXHIMIT PËR FUNKSIONIMIN E SIGURT TË ANIJEVE DHE PËR PARANDALIMIN E NDOTJES (KODI NDËRKOMBËTAR I MENAXHIMIT TË SIGURISË (ISM CODE))

Pjesa A - Zbatimi

1. Të përgjithshme
- 1.1 Termat
- 1.2 Objektivat
- 1.3 Zbatimi
- 1.4 Kërkesat funksionale për sistemin e menaxhimit të sigurisë (SMS)
2. Politika për mbrojtjen mjedisore dhe të sigurisë
3. Autoriteti dhe përgjegjësitë e kompanisë
4. Personi (personat) i caktuar
5. Autoriteti dhe përgjegjësitë e kapitenit
6. Burimet dhe personeli
7. Zhvillimi i planeve për operimet e anijeve
8. Gatishmëria në raste emergjence
9. Raporte dhe analiza të ngjarjeve të papajtueshme, aksidenteve dhe atyre të rrezikshme
10. Mirëmbajtja e anijes dhe pajisjeve të saj
11. Dokumentacioni
12. Verifikimi, rishikimi dhe vlerësimi i kompanisë

Pjesa B - Certifikimi dhe verifikimi

13. Certifikimi dhe verifikimi periodik
14. Certifikimi i përkohshëm
15. Verifikimi
16. Formularët e certifikatave

KODI NDËRKOMBËTAR I MENAXHIMIT PËR FUNKSIONIMIN E SIGURT TË ANIJEVE DHE PËR PARANDALIMIN E NDOTJES (KODI NDËRKOMBËTAR I MENAXHIMIT TË SIGURISË)

PJESA A - ZBATIMI

1. Të përgjithshme

1.1 Termat

Termat e mëposhtëm zbatohen për pjesët A dhe B të këtij kodi.

1.1.1 **Kodi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Sigurisë (ISM):** - Do të thotë Kodi Ndërkombëtar i Menaxhimit për Funkcionimin e Sigurt të Anijeve dhe për Parandalimin e Ndotjes miratuar nga Asambleja, dhe që mund të amendohet nga organizata.

1.1.2 “Kompani”: do të thotë zotëruesi i anijes apo ndonjë organizatë tjetër ose person të tillë si menaxheri ose qiramarrësi, i cili ka ndërmarrë nga zotëruesi i anijes përgjegjësitë për funksionimin e anijes dhe që me marrjen e përgjegjësisë të tilla, ka rënë dakord të ndërmarrë të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e caktuara nga Kodi.

1.1.3 “Administratë”: do të thotë qeveria e shtetit, ku është regjistruar anija.

1.1.4 “Sistem i Menaxhimit të Sigurisë”: do të thotë sistemi i strukturuar dhe dokumentuar, i cili mundëson personelin e kompanisë të zbatojë me efikasitet politikën e sigurisë së kompanisë dhe të mbrojtjes mjedisore.

1.1.5 “Dokument i përputhshmërisë”: do të thotë dokumenti i lëshuar një kompanie e cila vepron në përputhje me kërkesat e këtij Kodi.

1.1.6 “Certifikatë e menaxhimit të sigurisë”: do të thotë dokumenti i lëshuar një anijeje i cili nënkupton se menaxhimi i kompanisë dhe anijes veprojnë në përputhje me sistemin e miratuar të menaxhimit të sigurisë.

1.1.7 “Të dhëna objektive”: do të thotë informacione sasiore ose cilësore, procesverbale ose dëshmi faktesh që i përkasin sigurisë ose ekzistencës dhe zbatimit të sistemit të menaxhimit të sigurisë, të cilat bazohen në vëzhgimin, përmasat apo testin dhe që mund të verifikohen.

1.1.8 “Vëzhgim”: do të thotë dëshmi faktesh të bërë gjatë kontrollit të menaxhimit të sigurisë dhe të provuara nga të dhëna objektive.



1.1.9 “Papajtueshmëri”: do të thotë një situatë e vëzhguar ku të dhënat objektive tregojnë mos-përmbushjen e kërkesave të caktuara.

1.1.10 “Papajtueshmëri e rëndësishme”: do të thotë një shmangie e paidentifikueshme që përbën një kërcënim serioz për sigurinë e personelit ose anijes apo një rrezik serioz për mjedisin që kërkon masa të menjëhershme korrigjuese dhe përfshin mungesën e zbatimit efikas dhe sistematik të kërkesave të këtij Kodi.

1.1.11 “Datë e përvjetorit”: do të thotë data dhe muaji i çdo viti që i korrespondon datës së skadimit të dokumentit apo certifikatës përkatëse.

1.1.12 “Konventë”: do të thotë Konventa Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, e amenduar.

1.2 Objektivat

1.2.1 Objektivat e këtij Kodi synojnë sigurinë e jetës në det, parandalimin e dëmtimeve njerëzore apo humbjes së jetës dhe shmangien e dëmtimit të mjedisit, në veçanti të mjedisit detar dhe të pronës.

1.2.2 Objektivat e menaxhimit të sigurisë *inter alia* (ndër të tjera), duhet:

- Të parashikojnë praktika të sigurta në funksionimin e anijeve dhe mjedisin e sigurt të punës;

- Të përcaktojnë masa mbrojtëse ndaj të gjitha rreziqeve të identifikuara; dhe

- Të përmirësojnë vazhdimisht aftësitë e menaxhimit të sigurisë për personelin në breg dhe në bord të anijes, duke përfshirë gatishmërinë për raste emergjence lidhur si me sigurinë ashtu edhe me mbrojtjen mjedisore.

1.2.3 Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të sigurojë:

- Përputhje me rregullat dhe rregulloret e detyrueshme; dhe

- Se janë marrë në konsideratë kodi i zbatueshëm, udhëzuesit dhe standardet e rekomanduara nga organizata, administratat, shoqëritë e klasifikimit dhe organizatat e industrisë detare.

1.3 Zbatimi

Kërkesat e këtij Kodi mund të zbatohen për të gjitha anijet.

1.4. Kërkesat funksionale për sistemin e menaxhimit të sigurisë (SMS)

Çdo kompani duhet të zhvillojë, të zbatojë dhe të mirëmbajë sistemin e menaxhimit të sigurisë i cili përfshin kërkesat e mëposhtme funksionale:

1.4.1 Politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes mjedisore;

1.4.2 Udhëzimet dhe procedurat për të siguruar funksionimin e sigurt të anijeve dhe mbrojtjen e mjedisit në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit ku është regjistruar anija;

1.4.3 Nivelet e përcaktuara të autoritetit dhe linjat e komunikimit ndërmjet personelit në breg dhe në anije;

1.4.4 Procedurat për raportimin e aksidenteve dhe papajtueshmëritë me dispozitat e këtij kodi;

1.4.5 Procedurat për t'u përgatitur dhe për t'iu përgjigjur situatave emergjente; dhe

1.4.6 Procedurat për kontrollet e brendshme dhe rishikimet e menaxhimit.

2. Politika e sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore

2.1 Kompania duhet të përcaktojë një politikë të sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore, e cila përshkruan mënyrën se si do të arrihen objektivat e dhëna në paragrafin 1.2.

2.2 Kompania duhet të sigurojë se politika zbatohet dhe ruhet në të gjitha nivelet e organizatës si në anije ashtu edhe në breg.

3. Përgjegjësitë dhe autoriteti i kompanisë

3.1 Nëse subjekti përgjegjës për funksionimin e anijes nuk është zotëruesi i saj, atëherë ky i fundit duhet t'i raportojë administratës emrin e plotë dhe detaje për këtë subjekt.

3.2 Kompania duhet të përcaktojë dhe dokumentojë përgjegjësitë, autoritetin dhe ndërlidhjen e personelit që menaxhon, kryen dhe verifikon punën që ka të bëjë dhe ndikon në sigurinë dhe mbrojtjen nga ndotja.

3.3 Kompania është përgjegjëse për të siguruar se janë ofruar resurse të mjaftueshme dhe mbështetja e duhur në breg që mundësojnë personin apo personat e caktuar të kryejnë funksionet e tyre.

4. Personi (personat) e caktuar

Të sigurojë funksionimin e sigurt të çdo anijeje dhe të sigurojë lidhjen ndërmjet kompanisë dhe personave në bord; çdo kompani, sipas rastit, duhet të caktojë një person apo persona në breg që kanë mundësi të drejtpërdrejtë në nivelin më të lartë të menaxhimit. Përgjegjësia dhe autoriteti i personit apo personave duhet të përfshijë monitorimin e aspekteve të sigurisë dhe parandalimin e ndotjes në funksionimin e çdo anijeje dhe të sigurojë se



janë zbatuar siç duhet burimet e duhura dhe mbështetja në breg.

5. Përgjegjësia dhe autoriteti i kapitenit

5.1 Kompania duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të dokumentojë përgjegjësinë e kapitenit në lidhje me:

5.1.1 Zbatimin e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore të kompanisë;

5.1.2 Motivimin e ekuipazhit në respektimin e kësaj politike;

5.1.3 Lëshimin e urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë;

5.1.4 Verifikimin se janë respektuar kërkesat e veçanta; dhe

5.1.5 Rishikimin e SMS-së dhe raportimin e mangësive përkatëse të menaxhimit në breg.

5.1.6 Kompania duhet të sigurojë se SMS-ja që funksionon në bordin e anijes përmban një dëshmi të qartë që thekson autoritetin e kapitenit. Kompania duhet të përcaktojë në SMS se kapiteni ka autoritetin dhe përgjegjësinë kryesore për të marrë vendime në lidhje me sigurinë dhe parandalimin e ndotjes dhe të kërkojë ndihmën e kompanisë nëse është e nevojshme.

6. Burimet dhe personeli

6.1 Kompania duhet të sigurojë se kapiteni është:

6.1.1 I kualifikuar siç duhet për komandën;

6.1.2 I familjarizuar plotësisht me SMS-në e kompanisë; dhe

6.1.3 I është dhënë mbështetja e nevojshme me qëllim që detyrat e kapitenit të kryhen në mënyrë të sigurt.

6.2 Kompania duhet të sigurojë se çdo anije është pajisur me detarë të kualifikuar, të certifikuar dhe të përshtatshëm nga ana mjekësore në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare.

6.3 Kompania duhet të përcaktojë procedura për të siguruar se i është dhënë familjarizimi i duhur për detyrat përkatëse personelit të ri dhe personelit të transferuar në detyra të reja në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit.

6.4 Është e nevojshme që para lundrimit të sigurohen udhëzimet, të cilat duhet të përcaktohen, të dokumentohen dhe të jepen.

6.5 Kompania duhet të sigurojë se i gjithë personeli i përfshirë në SMS e kompanisë ka njohurinë e mjaftueshme të rregullave, rregulloreve, kodeve dhe udhëzuesve përkatës.

6.6 Kompania duhet të përcaktojë dhe të mirëmbajë procedurat për përcaktimin e çdo trajnimi që mund të kërkohe në mbështetje të SMS-së dhe të sigurojë se ky trajnim ofrohet për të gjithë personelin e interesuar.

6.7 Kompania duhet të përcaktojë procedurat nëpërmjet të cilave personeli i anijes merr informacionin përkatës mbi SMS-në në gjuhën e përdorur apo gjuhët e kuptuara prej tij.

6.8 Kompania duhet të sigurojë se personeli i anijes është në gjendje të komunikojë në mënyrë efektive për zbatimin e detyrave të tij lidhur me SMS-në.

7. Zhvillimi i planeve për operimet e anijeve

Kompania duhet të përcaktojë procedurat për përgatitjen e planeve dhe udhëzimeve, që përfshijnë sipas rastit listat e plota për operimet kryesore të anijes në lidhje me sigurinë e anijes dhe parandalimin e ndotjes. Detyrat e ndryshme të përfshira duhet të caktohen dhe t'i jepen një personeli të kualifikuar.

8. Gatishmëria në rast emergjence

8.1 Kompania duhet të përcaktojë procedurat për të identifikuar, përshkruar dhe për t'iu përgjigjur situatave të mundshme të emergjencës së anijeve.

8.2 Kompania duhet të përcaktojë programet për shpim-kërkimet dhe të ushtrohet për t'u përgatitur për veprimet e emergjencës.

8.3 SMS-ja duhet të parashikojë masat që sigurojnë se kompania mund t'i përgjigjet në çdo kohë rreziqeve, aksidenteve dhe situatave të emergjencës që përfshijnë anijen përkatëse.

9. Raportet dhe analizat e papajtueshmërive, aksidenteve dhe ngjarjeve të rrezikshme

9.1 SMS-ja përfshin procedurat që sigurojnë se papajtueshmëritë, aksidentet dhe situatat e rrezikshme i janë raportuar kompanisë, janë hetuar dhe analizuar duke synuar përmirësimin e sigurisë dhe parandalimin e ndotjes.

9.2 Kompania duhet të përcaktojë procedurat për zbatimin e masave korrigjuese.

10. Mirëmbajtja e anijes dhe pajisjeve të saj

10.1 Kompania duhet të përcaktojë procedurat që sigurojnë se anija është mbajtur në përputhje me dispozitat e rregullave dhe rregulloreve përkatëse dhe me çdo kërkesë tjetër shtesë që mund të përcaktohet nga kompania.



10.2 Në përmbushjen e këtyre kërkesave kompania duhet të sigurojë se:

10.2.1 Inspektimet janë kryer në intervale të duhura;

10.2.2 Çdo papajtueshmëri raportohet me shkakun e saj të mundshëm, nëse dihet;

10.2.3 Janë marrë masat e duhura korrigjuese; dhe

10.2.4 Janë ruajtur procesverbalet e këtyre veprimtarive.

10.3 Kompania duhet të përcaktojë procedurat në SMS për identifikimin e sistemeve teknike dhe të pajisjeve, mosfunksionimi i papritur i të cilave mund të rezultojë në situata të rrezikshme. SMS-ja duhet të parashikojë masa të veçanta që synojnë besueshmërinë e këtyre pajisjeve apo sistemeve. Këto masa duhet të përfshijnë testet e vazhdueshme të përgatitjeve dhe sistemeve teknike dhe të pajisjeve rezervë të cilat nuk janë në përdorim të mjaftueshëm.

10.4 Inspektimet e përmendura në 10.2, si dhe masat e referuara në 10.3 duhet të përfshihen në mirëmbajtjen/rutinën funksionale të anijes.

11. Dokumentimi

11.1 Kompania duhet të përcaktojë dhe të ruajë procedurat për kontrollin e të gjithë dokumenteve dhe të dhënave, që kanë lidhje me SMS-në.

11.2 Kompania duhet të sigurojë se:

11.2.1 Dokumente të vlefshme janë në dispozicion në të gjitha vendet përkatëse;

11.2.2 Ndryshimet e dokumenteve janë rishikuar dhe miratuar nga personeli i autorizuar; dhe

11.2.3 Dokumentet e dala jashtë përdorimit janë hequr.

11.3 Dokumentet e përdorura për të përshkruar dhe zbatuar SMS-në mund të referohen si “manuali i menaxhimit të sigurisë”. Dokumentacioni duhet të ruhet në formën që kompania e vlerëson më të dobishme. Çdo anije duhet të mbajë në bordin e saj të gjithë dokumentacionin përkatës të anijes.

12. Verifikimi, rishikimi dhe vlerësimi i kompanisë

12.1 Kompania duhet të kryejë kontrolle të brendshme sigurie për të verifikuar nëse siguria dhe parandalimi i ndotjes janë në përputhje me SMS-në.

12.2 Kompania duhet të vlerësojë në mënyrë periodike efikasitetin dhe kur është e nevojshme, të rishikojë SMS-në në përputhje me procedurat e përcaktuara nga kompania.

12.3 Kontrollat dhe masat e mundshme korrigjuese duhet të bëhen në përputhje me procedurat e dokumentuara.

12.4 Personeli që kryen kontrollet duhet të jetë i pavarur nga zona ku kryhet kontrolli nëse kjo është praktike për shkak të madhësisë dhe natyrës së kompanisë.

12.5 Rezultatet e kontrolleve dhe rishikimet duhet të jenë në vëmendjen e të gjithë personelit që ka përgjegjësi në zonën në fjalë.

12.6 Personeli i menaxhimit, përgjegjës për zonën në fjalë duhet të marrë masat e duhura korrigjuese mbi mangësitë e konstatuara.

PJESA B - CERTIFIKIMI DHE VERIFIKIMI

13. Certifikimi dhe verifikimi periodik

13.1 Anija duhet të drejtohet nga kompania së cilës i është lëshuar dokumenti i përputhshmërisë apo dokumenti i përkohshëm i përputhshmërisë sipas paragrafit 14.1, në lidhje me këtë anije.

13.2 Dokumenti i përputhshmërisë duhet të lëshohet nga administrata, nga një organizatë e njohur nga administrata ose, me kërkesën e administratës, nga një qeveri tjetër kontraktuese e Konventës për çdo kompani që vepron në përputhje me kërkesat e këtij Kodi për një periudhë të specifikuar nga administrata e cila nuk duhet të jetë më shumë se pesë vjet. Ky dokument duhet të pranohet si një dëshmi se kompania është në gjendje të veprojë në përputhje me kërkesat e këtij kodi.

13.3 Dokumenti i përputhshmërisë është i vlefshëm vetëm për anijet sipas llojit të treguar në dokumentin përkatës. Një tregues i tillë duhet të bazohet në llojet e anijeve për të cilat është bazuar verifikimi fillestar. Lloje të tjera anijesh duhet të shtohen pas verifikimit të aftësisë së kompanisë për të vepruar në përputhje me kërkesat e kodit të zbatueshëm për lloje të tilla anijesh. Në këtë kontekst llojet e anijeve janë ato të referuara në rregulloren IX/1 të Konventës.

13.4 Vlefshmëria e dokumentit të përputhshmërisë duhet t'i nënshtrohet verifikimit vjetor nga administrata ose nga një organizatë e njohur nga administrata ose, me kërkesën e administratës nga një qeveri tjetër kontraktuese brenda tre muajve para ose pas datës së përvjetorit.

13.5 Dokumenti i përputhjes duhet të tërhiqet nga administrata, ose, me kërkesën e saj, nga qeveria kontraktuese që ka lëshuar dokumentin, në



rastet kur nuk kërkohet verifikimi vjetor i kërkuar në paragrafin 13.4 ose në qoftë se ka të dhëna për papajtueshmëri të madhe me këtë Kod.

13.5.1 Të gjitha certifikatat e tjera të menaxhimit të sigurisë dhe/ose certifikatat e përkohshme të menaxhimit të sigurisë duhet gjithashtu të tërhiqen në qoftë se është tërhequr dokumenti i përputhshmërisë.

13.6 Një kopje e dokumentit të përputhshmërisë duhet të vendoset në bordin e anijes në mënyrë që kapiteni i saj, nëse kërkohet ta prodhojë atë për verifikim nga administrata ose nga organizata e njohur nga administrata apo për qëllimet e kontrollit të referuar në rregulloren IX/6.2 të Konventës. Kopja e dokumentit nuk është e nevojshme të jetë e vërtetuar ose certifikuar.

13.7 Certifikata e menaxhimit të sigurisë duhet t'i lëshohet një anijeje për një periudhë jo më shumë se pesë vjet nga administrata ose një organizatë e njohur nga administrata ose, me kërkesën e administratës, nga një qeveri tjetër kontraktuese. Certifikata e menaxhimit të sigurisë duhet të lëshohet pas verifikimit se kompania dhe menaxhimi i anijes veprojnë në përputhje me sistemin e miratuar të menaxhimit të sigurisë. Një certifikatë e tillë duhet të pranohet si dëshmi se anija vepron në përputhje me kërkesat e këtij kodi.

13.8 Vlefshmëria e certifikatës së menaxhimit të sigurisë duhet t'i nënshtrohet të paktën verifikimit të ndërmjetëm nga administrata ose një organizatë e njohur nga administrata ose, me kërkesën e administratës nga një qeveri tjetër kontraktuese. Nëse duhet të kryhet vetëm një verifikim i ndërmjetëm dhe periudha e vlefshmërisë së certifikatës së menaxhimit të sigurisë është pesë vjet, verifikimi përkatës duhet të bëhet ndërmjet datës së përvjetorit të dytë dhe të tretë të certifikatës së menaxhimit të sigurisë.

13.9 Përveç kërkesave të paragrafit 13.5.1, certifikata e menaxhimit të sigurisë duhet të tërhiqet nga administrata ose me kërkesën e administratës, nga qeveria kontraktuese që e ka lëshuar atë në rastet kur nuk kërkohet verifikimi i ndërmjetëm sipas paragrafit 13.8 ose në qoftë se ka dëshmi të papajtueshmërisë së rëndësishme me këtë kod.

13.10 Pavarësisht nga kërkesat e paragrafëve 13.2 dhe 13.7, kur verifikimi i rinovimit përfundohet brenda tre muajve përpara datës së skadimit të dokumentit ekzistues të përputh-

shmërisë apo certifikatës së menaxhimit të sigurisë, dokumenti i ri i përputhshmërisë apo certifikata e re e menaxhimit të sigurisë duhet të jetë e vlefshme që nga data e përfundimit të verifikimit të rinovimit për një periudhë jo më shumë se pesë vjet nga data e skadimit të dokumentit ekzistues të përputhshmërisë apo certifikatës së menaxhimit të sigurisë.

13.11 Kur verifikimi i rinovimit përfundon më shumë se tre muaj përpara datës së skadimit të dokumentit ekzistues të përputhshmërisë apo certifikatës së menaxhimit të sigurisë, dokumenti i ri i përputhshmërisë apo certifikata e re e menaxhimit të sigurisë duhet të jetë e vlefshme që nga data e përfundimit të verifikimit të rinovimit për një periudhë jo më shumë se pesë vjet nga data e përfundimit të verifikimit të rinovimit.

14. Certifikimi i përkohshëm

14.1 Dokumenti i përkohshëm i përputhjes mund të lëshohet për të lehtësuar zbatimin fillestar të këtij kodi kur: 1. kompania është krijuar rishtazi; ose 2. lloje të reja anijesh duhet t'i shtohen dokumentit ekzistues të Përputhshmërisë, pas verifikimit se kompania ka një sistem menaxhimi të sigurisë që përmbush objektivat e paragrafit 1.2.3 të këtij kodi me kusht që kompania të bëjë të njohura planet për zbatimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë që përmbush kërkesat e plota të këtij Kodi brenda periudhës së vlefshmërisë të dokumentit të përkohshëm të përputhshmërisë. Ky dokument i përkohshëm i përputhshmërisë duhet të lëshohet për një periudhë jo më shumë se 12 muaj nga administrata ose nga një organizatë e njohur nga administrata ose, me kërkesën e administratës nga një qeveri tjetër kontraktuese. Një kopje e dokumentit të përkohshëm të përputhshmërisë duhet të vendoset në bordin e anijes në mënyrë që kapiteni i saj, nëse kërkohet, ta prodhojë atë për verifikim nga administrata ose nga një organizatë e njohur nga administrata apo për qëllimet e kontrollit referuar në rregulloren IX/6.2 të Konventës. Kopja e dokumentit nuk është e nevojshme të jetë e vërtetuar apo certifikuar.

14.2 Certifikata e përkohshme e menaxhimit të sigurisë mund të lëshohet:

1. Për anijet e reja gjatë dorëzimit të mallit;

2. Kur një kompani ndërmerr përgjegjësinë për funksionimin e një anijeje e cila është e re për kompaninë; ose



3. Kur anija ndryshon regjistrimin. Kjo certifikatë e përkohshme e menaxhimit të sigurisë duhet të lëshohet për një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj nga administrata ose organizata e njohur nga administrata ose, me kërkesën e administratës, nga një qeveri tjetër kontraktuese.

14.3 Administrata ose, me kërkesën e administratës, një qeveri tjetër kontraktuese, në raste të veçanta, mund të zgjerojë vlefshmërinë e certifikatës së përkohshme të menaxhimit të sigurisë për një periudhë të mëtejshme jo më shumë se gjashtë muaj nga data e skadimit.

14.4 Certifikata e përkohshme e menaxhimit të sigurisë mund të lëshohet pasi verifikohet se:

1. Dokumenti i përputhshmërisë apo dokumenti i përkohshëm i përputhshmërisë, ka të bëjë me anijen në fjalë;

2. Sistemi i menaxhimit të sigurisë i ofruar nga kompania për anijen përkatëse përfshin elementet kryesore të këtij kodi dhe është vlerësuar gjatë kontrollit për lëshimin e dokumentit të përputhshmërisë ose është provuar për lëshimin e dokumentit të përputhshmërisë;

3. Kompania ka planifikuar kontrollin e anijes brenda tre muajve;

4. Kapiteni dhe pilotët janë familjarizuar me sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe me përgatitjet e planifikuara për zbatimin e tij;

5. Udhëzimet, të përcaktuara si thelbësore, janë paraqitur përpara lundrimit; dhe

6. Informacionet përkatëse mbi sistemin e menaxhimit të sigurisë janë dhënë në gjuhën e përdorur apo në gjuhët e kuptuara nga personeli i anijes.

15. Verifikimi

15.1 Të gjitha verifikimet e kërkuara sipas dispozitave të këtij kodi duhet të kryhen në përputhje me procedurat e pranueshme të administratës, duke marrë në konsideratë udhëzimet e zhvilluara nga organizata 1.

16. Formularët e certifikatave

16.1 Dokumenti i përputhshmërisë, certifikata e menaxhimit të sigurisë, dokumenti i përputhshmërisë dhe certifikata e përkohshme e menaxhimit të sigurisë duhet të përpilohen në një formë që i korrespondon modeleve të dhëna në shtojcën e këtij kodi. Nëse gjuha e përdorur nuk është anglisht ose frëngjisht, teksti duhet të përfshijë përkthimin në një nga këto gjuhë.

16.2 Përveç kërkesave të paragrafit 13.3, llojet e anijeve të treguara në dokumentin e përputhjes dhe në dokumentin e përkohshëm të përputhshmërisë, mund të miratohen për të pasqyruar çdo kufizim në funksionimin e anijeve të përshkruara në sistemin e menaxhimit të sigurisë.

1) Referojuni udhëzimeve të rishikuara mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM) nga administratat miratuar nga organizata nëpërmjet rezolutës A. 913 (22).



**Formularët e Dokumentit të Përputhshmërisë, Certifikatës së Menaxhimit të Sigurisë,
Dokumentit të Përkohshëm të Përputhshmërisë dhe Certifikatës së Përkohshme të
Menaxhimit të Sigurisë**



Republika e Shqipërisë

DOKUMENTI I PËRPUTHSHMËRISË

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS
NË DET, 1974, e amenduar

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizata e
autorizuar.....

Emri dhe adresa e kompanisë:

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET SE është kontrolluar sistemi i menaxhimit të sigurisë të kompanisë dhe është vepruar në përputhje
me kërkesat e Kodit Nderkombëtar të Menaxhimit për Funksionimin e Sigurt të Anijeve dhe për Parandalimin e
Ndotjes (Kodi ISM) për llojet e anijeve të renditura më poshtë (fshihet sipas rastit):

Anije pasagjerësh

Anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë

Anije mallrash me shpejtësi të lartë

Transportues për mallra të paambalazuara

Anije naftëmbajtëse

Anije-cisternë për lëndë kimike

Transportues gazi

Njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur

Anije të tjera mallrash

Dokumenti i Përputhshmërisë është i vlefshëm deri, në varësi të verifikimit periodik.

Lëshuar

(vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që lëshon dokumentin)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)



Certifikatë Nr.

MIRATIMI PËR VERIFIKIM VJETOR

VËRTETOHET se, gjatë verifikimeve periodike në përputhje me Rregulloren IX/6.1 të Konventës dhe paragrafit 13.4 të Kodit ISM, është konstatuar se sistemi i menaxhimit të sigurisë ka qenë në përputhje me kërkesat e Kodit ISM.

VERIFIKIMI I PARË VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:

Data:

VERIFIKIMI I DYTË VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:

Data:

VERIFIKIMI I TRETË VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:

Data:

VERIFIKIMI I KATËRT VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:

Data:



CERTIFIKATE E MENAXHIMIT TE SIGURT



Republika e Shqipërisë

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974, e amenduar

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizata e autorizuar.....

Emri i anijes:

Numri ose shkronjat dalluese:

Porti i regjistrimit:

Lloji i anijes(*):

Tonazhi bruto:

Numri IMO:

Emri dhe adresa e kompanisë:

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET se është kontrolluar sistemi i menaxhimit të sigurisë së anijes dhe është vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit për Funkcionimin e Sigurt të Anijeve dhe për Parandalimin e Ndotjes (Kodi ISM) pas verifikimit se Dokumenti i Përputhshmërisë për kompaninë është i zbatueshëm për këtë lloj anijeje.

Dokumenti i Përputhshmërisë është i vlefshëm deri, në varësi të verifikimit periodik dhe vlefshmërisë së Dokumentit të Përputhshmërisë.

Lëshuar në.....(vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që lëshon dokumentin)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)

(*) Përfshini llojin e anijes si më poshtë: anije pasagjerësh; anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë; anije mallrash me shpejtësi të lartë; transportues për mallra të paambalazuara; anije naftëmbajtëse; anije-cisternë për lëndë kimike; transportues gazi; njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur; anije të tjera mallrash.



Certifikatë Nr.

**MIRATIMI PËR VERIFIKIMIN E NDËRMJETËM DHE VERIFIKIMIN SHITESË
(NËSE KËRKOHEË)**

VËRTETOHEË se, gjatë verifikimeve periodike në përputhje me Rregulloren IX/6.1 të Konventës dhe paragrafit 13.8 të Kodit ISM, është konstatuar se sistemi i menaxhimit të siguriisë ka qenë në përputhje me kërkesat e Kodit ISM.

VERIFIKIMI I Ndërmjetëm:
 NDËRMJETËM (të plotësohet
 ndërmjet datës së përvjetorit të (Nënskrimi i punonjësit të autorizuar)
 dytë dhe të tretë)

Vendi:

Data:

VERIFIKIME SHITESË (*) Ndënskrimi:

 (Nënskrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:

Data:

VERIFIKIME SHITESË(*) Ndënskrimi:
 (Nënskrimi i punonjësit të
 autorizuar).....

Vendi:

Data:

VERIFIKIME SHITESË (*) Ndënskrimi:

 (Nënskrimi i punonjësit të autorizuar).....

Vendi:

Data:

(*) Nëse mund të zbatohet. Referimi është bërë në paragrafin 3.4.1 të Udhëzuesit për Zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Siguriisë (ISM) nga Administratat përkatëse (Rezoluta A.913(22)).



DOKUMENTI I PERKOHSHEM I PERPUTHSHMERISE



Republika e Shqipërisë

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, (SOLAS) 1974, e amenduar

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizata e autorizuar.....

Emri dhe adresa e kompanisë:

.....

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET se është njohur që sistemi i menaxhimit të sigurisë së kompanisë ka përmbushur objektivat e paragrafit 1.2.3 të Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit për Funkcionimin e Sigurt të Anijeve dhe për Parandalimin e Ndotjes (Kodi ISM) për llojin (llojet) e anijeve të renditura më poshtë (fshihet sipas rastit):

Anije pasagjerësh

Anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë

Anije mallrash me shpejtësi të lartë

Transportues për mallra të paambalazhuara

Anije naftëmbajtëse

Anije-cisternë për lëndë kimike

Transportues gazi

Njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur

Anije të tjera mallrash

Dokumenti i Përputhshmërisë është i vlefshëm deri....., në varësi të verifikimit periodik.

Lëshuar në(Vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

.....

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që ka lëshuar dokumentin)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)



CERTIFIKATE E PERKOHSHME E MENAXHIMIT TE SIGURISE



Republika e Shqipërisë

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS
NË DET, 1974, e amenduar

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizatë e
autorizuar.....

Emri i anijes:

Numri ose shkronjat dalluese:

Porti i regjistrimit:

Lloji i anijes(*):

Tonazhi bruto:

Numri IMO:

Emri dhe adresa e kompanisë:

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET se janë përmbushur kërkesat e paragrafit 14.4 të Kodit ISM dhe Dokumenti i
Përputhshmërisë /Dokumentit i Përkohshëm i Përputhshmërisë (**) i kompanisë është i
rëndësishëm për anijen.

Certifikata e Menaxhimit të Sigurisë është e vlefshme deri

më....., në varësi të verifikimeve
periodike dhe Dokumentit të Përputhshmërisë /Dokumentit të Përkohshëm të Përputhshmërisë (**) që është i
vlefshëm.

Lëshuar në.....(Vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që ka lëshuar certifikatën)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)

(*) Përfshini llojin e anijes si më poshtë: anije pasagjerësh; anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë; anije mallrash me
shpejtësi të lartë; transportues për mallra të paambalazuara; anije naftëmbajtëse; anije-cisternë për lëndë kimike;
transportues gazi; njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur; anije të tjera mallrash.

(**) Fshihet sipas rastit.



ANEKSI II
DISPOZITA PËR ADMINISTRATËN
DETARE NË LIDHJE ME ZBATIMIN E
KODIT NDËRKOMBËTAR TË
MENAXHIMIT TË SIGURISË (ISM CODE)

Pjesa A, Dispozita të përgjithshme

Pjesa B, Certifikimi dhe standardet

2. Procesi i certifikimit

3. Standardet e menaxhimit

4. Standardet e kompetencës

5. Formularët e dokumenteve të përputhshmërisë dhe certifikatave të menaxhimit të sigurisë

PJESA A - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Kur kryen detyrat e verifikimeve dhe certifikimeve sipas dispozitave të Kodit ISM për anijet që i përkasin objektit të kësaj rregulloreje, administrata detare vepron në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në pjesën B të këtij titulli.

1.2 Përveç kësaj, administrata detare i kushton vëmendjen e duhur dispozitave të udhëzuesve të rishikuara për zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM) nga administratat përkatëse, miratuar nga IMO nëpërmjet rezolutës A.913(22), datë 29 nëntor 2001, për sa kohë që ato nuk mbulohen nga pjesa B e këtij titulli.

PJESA B - CERTIFIKIMI DHE STANDARDET

2. Procesi i certifikimit

2.1 Procesi i certifikimit në lidhje me lëshimin e dokumentit të përputhshmërisë për një kompani dhe certifikatën e menaxhimit të sigurisë për çdo anije, do të kryhet duke marrë në konsideratë dispozitat e përcaktuara më poshtë.

2.2 Procesi i certifikimit normalisht përfshin hapat e mëposhtëm:

2.2.1 Verifikimin fillestar;

2.2.2 Verifikimin vjetor ose të ndërmjetëm;

2.2.3 Verifikimin e rinovimit; dhe

2.2.4 Verifikimin shtesë.

Këto verifikime kryhen me kërkesë të kompanisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare apo pranë organizatës së njohur kur vepron në emër të administratës.

2.3 Verifikimet duhet të përfshijnë kontrollin e menaxhimit të sigurisë.

2.4 Për të kryer kontrollin, emërohet një drejtues kontrolli dhe, nëse është e rëndësishme, një grup kontrolli.

2.5 Drejtuesi i emëruar i kontrollit lidhet me kompaninë dhe krijon një plan kontrolli.

2.6 Raporti i kontrollit përgatitet nën drejtimin e kryesuesit të kontrollit, i cili është përgjegjës për saktësinë dhe përfundimin e tij.

2.7 Raporti i kontrollit përfshin planin e kontrollit, identifikimin e anëtarëve të grupit të kontrollit, datën dhe identifikimin e kompanisë, procesverbalet mbi vëzhgimet dhe papajtueshmëritë si dhe vëzhgimet mbi efektshmërinë e sistemit të menaxhimit të sigurisë për përmbushjen e objektivave të specifikuara.

3. Standardet e menaxhimit

3.1 Kontrolluesit apo grupi i kontrollit që menaxhon verifikimin e përputhjes me Kodin ISM, kanë kompetencë në lidhje me:

1. Sigurimin e përputhjes me rregullat dhe rregulloret që përfshijnë certifikimin e detarëve, për çdo lloj anijeje që drejtohet nga kompania;

2. Miratimin, shqyrtimin dhe certifikimin në lidhje me certifikatat detare;

3. Kushtet që duhet të merren në konsideratë në kuadrin e sistemit të menaxhimit të sigurisë sipas Kodit ISM; dhe

4. Përvojën praktike të funksionimit të anijes.

3.2 Në kryerjen e verifikimit të përputhjes me dispozitat e Kodit ISM, sigurohet ekzistenca e pavarësisë ndërmjet personelit që ofron shërbime konsulence dhe atij të përfshirë në procedurat e certifikimit.

4. Standardet e kompetencës

4.1 Kompetenca kryesore për kryerjen e verifikimit

4.1.1 Personeli që duhet të marrë pjesë në verifikimin e përputhjes me kërkesat e Kodit ISM, duhet të përmbushë kriteret minimale për inspektorët siç përcaktohet në rregulloren për inspektimin e anijeve.

4.1.2 Personeli duhet të ketë kryer trajnime për të siguruar kompetencën dhe aftësitë e duhura për kryerjen e verifikimit të përputhjes me kërkesat e Kodit ISM, veçanërisht në lidhje me:

a) Njohurinë dhe kuptimin e Kodit ISM;

b) Rregullat dhe rregulloret e detyrueshme;

c) Kushtet që sipas Kodit ISM kompania duhet të marrë në konsideratë;



d) Teknikat e vlerësimit për shqyrtimin, pyetjen, vlerësimin dhe raportimin;

e) Aspektet teknike apo funksionale të menaxhimit të sigurisë;

f) Njohuritë kryesore të transportit dhe operimeve të anijeve; dhe

g) Pjesëmarrja të paktën në një kontroll për menaxhimin e sigurisë që lidhet me marinën.

4.2 Kompetenca për verifikimin fillestar dhe verifikimet e rinovimit

4.2.1 Me qëllim që të vlerësohet plotësisht nëse kompania apo çdo lloj anijeje vepron në përputhje me kërkesat e Kodit ISM, përveç kompetencave kryesore të shprehura më lart, personeli që duhet të kryejë verifikimet fillestare apo verifikimet e rinovimit për dokumentin e përputhjes dhe certifikatën e menaxhimit të sigurisë, duhet të ketë kompetenca në mënyrë që:

a) Të përcaktojë nëse elementet e sistemit të menaxhimit të sigurisë (SMS) janë në përputhje me Kodin ISM;

b) Të përcaktojë efektivitetin e SMS-së të kompanisë, apo efektivitetin e çdo lloj anijeje, për të siguruar përputhjen me rregullat dhe rregulloret e evidentuara nga procesverbalet e kontrollit të klasifikimit dhe atij ligjor;

c) Të vlerësojë efektivitetin e SMS-së në sigurimin e përputhjes me rregullat dhe rregulloret

e tjera të cilat nuk mbulohen nga kontrollet ligjore dhe të klasifikimit dhe mundësojnë verifikimin e përputhjes me këto rregulla dhe rregullore; dhe

d) Të vlerësojë nëse janë marrë në konsideratë praktikatat e sigurta të rekomanduara nga IMO, administratat, shoqëritë e klasifikimit dhe organizatat e industrisë detare.

4.2.2 Kjo kompetencë mund të kryhet në grupe, të cilat së bashku posedojnë kompetencën totale të duhur

5. Formulari i dokumentit të përputhshmërisë dhe certifikatës së menaxhimit të sigurisë

Kur anijet veprojnë vetëm në Shqipëri, do të përdorin ose formularët bashkangjitur Kodit ISM ose dokumentet e përputhshmërisë, dokumentet e përkohshme të përputhshmërisë, certifikatat e menaxhimit të sigurisë, certifikatat e përkohshme të menaxhimit të sigurisë sipas formularit të përcaktuar më poshtë.

Në rastin e derogimit sipas paragrafit 1, të nenit 11 dhe nëse është e zbatueshme, sipas paragrafit 2, të nenit 11, certifikata e lëshuar do të jetë e ndryshme nga ajo e përmendur më sipër dhe të tregojë qartësisht që është bërë derogimi në përputhje me paragrafin 1, të nenit 11 dhe, nëse është e zbatueshme, me paragrafin 2, të nenit 11, të kësaj rregulloreje dhe përfshin kufizimet e zbatueshme funksionale.



Republika e Shqipërisë

DOKUMENTI I PËRPUTHSHMËRISË

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të [KONVENTËS NDERKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974, e amenduar dhe](*) Vendimit të KM Nr. __, datë __/__/2015 Rregullores Mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizata e autorizuar.....

Emri dhe adresa e kompanisë:

.....

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET se është kontrolluar sistemi i menaxhimit të sigurisë të kompanisë dhe është vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit për Funkcionimin e Sigurt të Anijeve dhe për Parandalimin e Ndotjes (Kodi ISM) për llojet e anijeve të renditura më poshtë (fshihet sipas rastit):

Anije pasagjerësh

Anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë

Anije mallrash me shpejtësi të lartë

Transportues për mallra të paambalazuara

Anije naftëmbajtëse

Anije-cisternë për lëndë kimike

Transportues gazi

Njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur

Anije të tjera mallrash

Anije pasagjerësh Ro-Ro

Dokumenti i Përputhshmërisë është i vlefshëm deri, në varësi të verifikimit periodik.

Lëshuar në

(vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që lëshon dokumentin)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)

* Mund të fshihet për rastet kur bëhet derogimi për transport të brendshëm.



Certifikatë Nr.

MIRATIMI PËR VERIFIKIM VJETOR

VËRTETOHET se, gjatë verifikimeve periodike në përputhje me [Rregulloren IX/6.1 të Konventës dhe paragrafit 13.4 të Kodit ISM dhe]* Vendimit të KM Nr. __, datë __/__/2015 për miratimin e Rregullores Mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code) është konstatuar se sistemi i menaxhimit të sigurisë ka qenë në përputhje me kërkesat e Kodit ISM.

VERIFIKIMI I PARË VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:.....

Data:.....

VERIFIKIMI I DYTË VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:.....

Data:.....

VERIFIKIMI I TRETË VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:.....

Data:.....

VERIFIKIMI I KATËRT VJETOR Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

Vendi:.....

Data:.....

* Mund të fshihet për rastet kur bëhet derogimi për transport të brendshëm



CERTIFIKATE E MENAXHIMIT TE SIGURT



Republika e Shqipërisë

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të [KONVENTËS NDERKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974, e amenduar, dhe]* Vendimit të KM Nr. ___, datë __/__/2015 për miratimin e Rregullores Mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizata e autorizuar.....

Emri i anijes:

Numri ose shkronjat dalluese:

Porti i regjistrimit:

Lloji i anijes(**):

Tonazhi bruto:

Numri IMO:

Emri dhe adresa e kompanisë:

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET se është kontrolluar sistemi i menaxhimit të sigurisë së anijes dhe është vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit për Funksionimin e Sigurt të Anijeve dhe për Parandalimin e Ndotjes (Kodi ISM) pas verifikimit se Dokumenti i Përputhshmërisë për kompaninë është i zbatueshëm për këtë lloj anijeje.

Dokumenti i Përputhshmërisë është i vlefshëm deri, në varësi të verifikimit periodik dhe vlefshmërisë së Dokumentit Përputhshmërisë.

Lëshuar në.....(vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që lëshon dokumentin)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)

* Mund të fshihet për rastet kur bëhet derogimi për transport të brendshëm.

** Përfshini llojin e anijes si më poshtë: anije pasagjerësh; anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë; anije mallrash me shpejtësi të lartë; transportues për mallra të paambalazuara; anije naftëmbajtëse; anije-cisternë për lëndë kimike; transportues gazi; njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur; anije të tjera mallrash.



Certifikatë Nr.

**MIRATIMI PËR VERIFIKIMIN E NDËRMJETËM DHE VERIFIKIMIN SHITESË
(NËSE KËRKOHE)**

VËRTETOHEJ se, gjatë verifikimeve periodike në përputhje me [Rregulloren IX/6.1 të Konventës dhe paragrafit 13.8 të Kodit ISM, dhe]* Nenit 11 i Vendimit të KM Nr. ___, datë __/__/2015 për miratimin e Rregullores Mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code) është konstatuar se sistemi i menaxhimit të sigurisë ka qenë në përputhje me kërkesat e Kodit ISM.

VERIFIKIMI I

NDËRMJETËM (të plotësohet
ndërmjet datës së përvjetorit të
dytë dhe të tretë)

Nënshkroi:

.....

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

.....

Vendi:.....

Data:

VERIFIKIME SHITESË ()**

Nënshkroi:

.....

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar)

.....

Vendi:.....

Data:

VERIFIKIME SHITESË()**

Nënshkroi:

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar).....

Vendi:.....

Data:

VERIFIKIME SHITESË ()**

Nënshkroi:

.....

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar).....

Vendi:.....

Data:

* Mund të fshihet për rastet kur bëhet derogimi për transport të brendshëm.

** Nëse mund të zbatohet. Referimi është bërë në paragrafin 3.4.1 të Udhëzuesit për Zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM) nga Administratat përkatëse (Rezoluta A.913(22)).



DOKUMENTI I PERKOHSHEM I PERPUTHSHMERISE



Republika e Shqipërisë

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të [KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, (SOLAS) 1974, e amenduar, dhe]* Vendimit të KM Nr. ___, datë __/__/2015 për miratimin e Rregullores Mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizata e autorizuar.....

Emri dhe adresa e kompanisë:.....

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET se është njohur që sistemi i menaxhimit të sigurisë së kompanisë ka përmbushur objektivat e paragrafit 1.2.3 të Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit për Funksonimin e Sigurt të Anijeve dhe për Parandalimin e Ndotjes (Kodi ISM) për llojin (llojet) e anijeve të renditura më poshtë (fshihet sipas rastit):

Anije pasagjerësh

Anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë

Anije mallrash me shpejtësi të lartë

Transportues për mallra të paambalazhuara

Anije naftëmbajtëse

Anije-cisternë për lëndë kimike

Transportues gazi

Njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur

Anije të tjera mallrash

Dokumenti i Përputhshmërisë është i vlefshëm deri, në varësi të verifikimit periodik.

Lëshuar në(Vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që ka lëshuar dokumentin)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)

* Mund të fshihet për rastet kur bëhet derogimi për transport të brendshëm.



CERTIFIKATE E PERKOHSHME E MENAXHIMIT TE SIGURISE



Republika e Shqipërisë

Certifikatë Nr.

Lëshuar sipas dispozitave të [KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974, e amenduar, dhe]* Nenit 11 i Vendimit të KM Nr. ___, datë ___/___/2015 për miratimin e Rregullores Mbi zbatimin e Kodit Ndërkombëtar të Menaxhimit të Sigurisë (ISM Code)

Nën autoritetin e Qeverisë Shqiptare nga Administrata Detare/ose organizatë e autorizuar.....

Emri i anijes:

Numri ose shkronjat dalluese:

Porti i regjistrimit:

Lloji i anijes(**):

Tonazhi bruto:

Numri IMO:

Emri dhe adresa e kompanisë:

(Shih paragrafin 1.1.2 të Kodit ISM)

VËRTETOHET se janë përmbushur kërkesat e paragrafit 14.4 të Kodit ISM dhe Dokumenti i Përputhshmërisë /Dokumentit të Përkohshëm i Përputhshmërisë (**) i kompanisë është i rëndësishëm për anijen.

Certifikata e Menaxhimit të Sigurisë është e vlefshme deri më....., në varësi të verifikimeve periodike dhe Dokumentit të Përputhshmërisë /Dokumentit të Përkohshëm të Përputhshmërisë (***) që është i vlefshëm.

Lëshuar në.....(Vendi i lëshimit të dokumentit)

Data e lëshimit

(Nënshkrimi i punonjësit të autorizuar sipas rregullave që ka lëshuar certifikatën)

(Vula ose stampa e autoritetit lëshues, sipas rastit)

* Mund të fshihet për rastet kur bëhet derogimi për transport të brendshëm.

** Përfshini llojin e anijes si më poshtë: anije pasagjerësh; anije pasagjerësh me shpejtësi të lartë; anije mallrash me shpejtësi të lartë; transportues për mallra të paambalazuara; anije naftëmbajtëse; anije-cisternë për lëndë kimike; transportues gazi; njësi e lëvizshme shpim-kërkimi në det të hapur; anije të tjera mallrash.

*** Fshihet sipas rastit

**VENDIM****Nr. 810, datë 16.11.2016****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 198, DATË 4.5.1993, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 198, datë 4.5.1993, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Këshilli drejtues i EKB-së përbëhet nga 7 anëtarë:

- Përfaqësues nga aparati i Kryeministrit 1;
- Përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban 4;
- Përfaqësues nga Ministria e Financës 1;
- Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së 1.”.

2. Kudo në tekst, emërtimi “Ministria e Punëve Publike” zëvendësohet me “Ministria e Zhvillimit Urban”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 812, datë 16.11.2016****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.608, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË KALIMIT TË PRONËSISË TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË NDËRTUARA DERI MË 10.8.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDohen AKTE FITIMI PRONËSIE, SI DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të nenit 25, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të pikave 3 dhe 4, të nenit 30, dhe të pikës 2, të nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 608, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në përmbajtjen e vendimit fjala “komunë”, hiqet.

2. Kudo në përmbajtjen e vendimit fjalët “Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, zëvendësohen me fjalët “Agjencia e Trajtimit të Pronës”.

3. Shkronja “b”, e pikës 6, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“b) Verifikimi i kushteve bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga punonjësit e tij, si dhe nga marrja e informacionit zyrtar nga institucionet shtetërore. Në çdo rast, institucioni i autorizuar kërkon detyruesisht informacion zyrtar pranë zyrës përkatëse vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencisë së Trajtimit të Pronave, ALUIZNI-t, zyrës së gjendjes civile dhe/apo çdo organi tjetër shtetëror që administron të dhëna apo informacion për pasurinë e paluajtshme objekt shqyrtimi, dhe për vërtetimin e gjendjes familjare të poseduesit të pasurisë së paluajtshme përpara datës 10.8.1991. Korrespondenca bëhet pjesë e dosjes. Çdo institucion shtetëror është i detyruar të kthejë përgjigje, me shkrim, brenda 10 (dhjetë)



ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Në rast të moskthimit të përgjigjes brenda këtij afati, drejtuesi i institucionit të autorizuar njofton, me shkrim, ministrin e Drejtësisë dhe kabinetin e Kryeministrit.”.

4. Pika 8, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“8. Institucioni i autorizuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga miratimi i këshillit të qarkut, bën kalimin e pronësisë së pasurive së paluajtshme e të truallit funksional të tyre, në emër të personave, sipas përbërjes familjare që figuron në certifikatën familjare deri më 10.8.1991, dhe e dërgon vendimin për regjistrim në ZVRPP-në kërkuese, duke vënë në dijeni dhe personat përfitues. Vendimit i bashkëlidhet kopja e njësuar e dosjes me dokumentacionin e plotë. Së bashku me dërgimin e vendimit për regjistrim institucioni i autorizuar (bashkia) njofton ZVRPP-në edhe për faktin nëse subjekti përfitues ka kryer ose jo pagesën e tarifës së shërbimit dhe pagesën e çmimit për tjetërsimin e truallit funksional.

Në rast se shqyrtimi i kërkesës në institucionin e autorizuar është iniciuar me kërkesë të individit, institucioni i autorizuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga miratimi i këshillit të qarkut, por përpara nënshkrimit të aktit përfundimtar të kalimit të pronësisë dhe dërgimit të tij për regjistrim, njofton zyrtarisht kërkuuesin për vlerësimin pozitiv të kërkesës, si dhe për detyrimin për të paguar brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për llogari të Agjencisë së Trajtimit të Pronës, për fondin e kompensimit financiar, çmimin e truallit, duke i treguar edhe numrin e llogarisë. Në njoftim jepen të dhëna për kufijtë, sipërfaqen në m² dhe vendndodhjen e pasurisë objekt kalimi në pronësi, të shoqëruar me genplanin dhe planimetrinë përkatëse. Kërkuesi, me marrjen e njoftimit, paguan në numrin e llogarisë së caktuar, për llogari të fondit të kompensimit të pronave, kundërvlerën në lekë për sipërfaqen e truallit që do të kalojë në pronësi të tij.

Vlera në lekë që do të paguhet nga kërkuesi për kalimin në pronësi të truallit dhe që përfshihet në ato raste që parashikon shkronja “b”, e pikës 4, e vendimit, është sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Me paraqitjen e dokumentit bankar që vërteton kryerjen e pagesës së kalimit në pronësi të truallit,

institucioni i autorizuar, brenda 20 ditëve nga administrimi i tij, nënshkruan aktin përfundimtar të kalimit të pronësisë së pasurive së paluajtshme e të truallit funksional të tyre në emër të personave, sipas përbërjes familjare që figuron në certifikatën familjare deri më 10.8.1991, dhe e dërgon vendimin për regjistrim në ZVRPP-në përkatëse, duke vënë në dijeni dhe personat përkatës përfitues. Vendimit i bashkëlidhet dokumentacioni hartografik që evidenton pasurinë objekt kalimi në pronësi, kopja e njësuar e dosjes me dokumentacionin e plotë e cila përfshin dhe dokumentacionin bankar që vërteton kryerjen e pagesës së truallit.

Për ndjekjen e procedurave të kalimit në pronësi, sipas këtij vendimi, paguhet tarifa e shërbimit, e cila vilet nga institucioni i autorizuar. Masa e tarifës së shërbimit caktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe të ministrit të Drejtësisë. Në rastet kur procedura është iniciuar me kërkesë të personit të interesuar, vjelja e tarifës së shërbimit bëhet paraprakisht me paraqitjen e kërkesës dhe fillimin e shqyrtimit të saj.”.

5. Pika 10 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“10. Në rast se procedura e kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme, sipas këtij vendimi, nuk ka nisur me kërkesë të përfituesit, dhe ndërkohë organi i autorizuar ka përcjellë dokumentacionin për regjistrim, shoqëruar dhe me të dhënat përkatëse, atëherë, përpara pajisjes me certifikatë pronësie, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 7 (shtatë) ditëve nga administrimi i akteve është e detyruar të njoftojë subjektin përfitues, për:

- të realizuar pagesën e tarifës së shërbimit, për llogari të institucionit të autorizuar, në numrin e llogarisë bankare të këtij të fundit. Masa e tarifës së shërbimit caktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe të ministrit të Drejtësisë; si dhe

- detyrimin për të realizuar pagesën për çmimin për kalimin në pronësi të truallit. Kërkuesi, me marrjen e njoftimit, paguan në numrin e llogarisë së caktuar, për llogari të Agjencisë së Trajtimit të Pronës për fondin e kompensimit të pronave, kundërvlerën në lekë për sipërfaqen e truallit që ka kaluar në pronësi të tij, sipas vendimit të institucionit të autorizuar, pagesë kjo e cila i referohet aneksit nr.3, bashkëlidhur këtij vendimi.



Pas administrimit të dokumentacionit bankar që vërteton kryerjen e këtyre pagesave, zyra e regjistrimit, nëse nuk ka vërejtje apo kundërshtime të tjera, vijon shqyrtimin e praktikës.”.

6. Në pikën 15, fjalët “Ministria e Brendshme”, hiqen.

II. Në rastin e kërkesave tashmë të paraqitura dhe për të cilat institucioni i autorizuar nuk ka dhënë ende vendim, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shqyrtimi i kërkesës dhe i dokumentacionit do të vazhdojë duke plotësuar edhe kushtet e parashikuara nga ky vendim.

III. Ngarkohen ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI NR. 3

ÇMIMET PËR TRUALLIN QË KALON NË PRONËSI SIPAS KËTIJ VENDIMI

Për sipërfaqe deri në 100 m ²	200 mijë lekë
Për sipërfaqe nga 101 m ² deri në 200 m ²	300 mijë lekë
Për sipërfaqe nga 201 m ² deri në 300 m ²	400 mijë lekë
Për sipërfaqe nga 301 m ² deri në 400 m ²	500 mijë lekë
Për sipërfaqe nga 401 m ² deri në 500 m ²	600 mijë lekë

VENDIM

Nr. 813, datë 16.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.253, DATË 6.3.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PLOTËSIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI PËR FAMILJET BUJQËSORE NË FSHATRA E ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në vendim:

a) Emërtimi “njësi e qeverisjes vendore” zëvendësohet me “bashkia”.

b) Emërtimi “Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore” zëvendësohet me “Këshilli Bashkiak”.

2. Paragrafi i parë, i pikës 1 dhe shkronja “a” ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. Kryetari i bashkisë:

a) afishon në vendet publike të bashkisë dhe të njësisë administrative dhe boton në gazetën e pushtetit vendor apo në njërin nga gazetatat e përditshme, vendore ose kombëtare, lajmërimin publik të paraqitjes së dokumentacionit, sipas pikës 2, të këtij vendimi, për të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativës bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP), sipas përcaktimeve të pikës 1/1, të nenit 17, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, nëse ky lajmërim nuk është bërë më parë për gjithë territorin e bashkisë apo për njësi administrative të veçanta;”.

3. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativave bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga përfundimi i afatit ligjor të plotësimit të dokumentacionit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:”.

4. Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Këshilli Bashkiak, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përcakton me vendim të marrë në përputhje me pikën 4, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, emrat e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore për çdo fshat, në bashki, si dhe emrat e subjekteve përfituese që plotësojnë kushtet ligjore për t’u pajisur me AMTP, vendndodhjen e tokës, sipërfaqen, kufizimet dhe kufitarët për çdo ngastër, të shoqëruar me hartën kadastrale, si pjesë përbërëse të tij, dhe me relacion të hollësishëm.”.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 814, datë 16.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 337, DATË 22.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KRYERJES SË PROCESIT TË KALIMIT TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE NË PRONËSI TË PËRFITUESVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimet:

a) “njësi e qeverisjes vendore” zëvendësohen me “bashkia”;

b) “këshilli i njësisë së qeverisjes vendore” zëvendësohen me “këshilli bashkiak”.

2. Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“a) Kryetari i bashkisë afishon në vendet publike të bashkisë e të njësisë administrative dhe boton në gazetën e pushtetit vendor apo në një tërësi nga gazetatat e përditshme vendore ose kombëtare lajmërimin publik të paraqitjes së dokumentacionit, sipas pikave 2 e 3, të këtij vendimi, për të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP), sipas përcaktimeve të nenit 2, të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, në se ky lajmërim nuk

është bërë më parë për gjithë territorin e bashkisë apo për njësi administrative të veçanta;”.

3. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshon, me këtë përmbajtje:

“2. Përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, jo më vonë se 3 muaj, nga përfundimi i afatit ligjor të plotësimit të dokumentacionit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:”.

4. Paragrafi i parë, i pikës 3, ndryshon me këtë përmbajtje:

“3. Subjektet e përcaktuara si bashkëthemeluese të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, të cilat nuk janë pajisur me AMTP për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik, jo më vonë se 3 muaj, nga përfundimi i afatit ligjor të plotësimit të dokumentacionit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, paraqesin në njësinë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës gjendet toka bujqësore:”.

5. Pika 14 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“14. Këshilli bashkiak, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, përcakton me vendim, të marrë në përputhje me pikën 4, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, emrat e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore për çdo fshat në bashki si dhe emrat e subjekteve përfituese, që plotësojnë kushtet ligjore për t’u pajisur me AMTP, vendndodhjen e tokës, sipërfaqen, kufizimet dhe kufitarët për çdo ngastër, të shoqëruar me hartën kadastrale, si pjesë përbërëse të tij, dhe me relacion të hollësishëm.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 815, datë 16.11.2016****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR TRANSPORTIN E SIGURT TË
MATERIALEVE RADIOAKTIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për transportin e sigurt të materialeve radioaktive”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 488, datë 23.6.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore për transportin e sigurt të lëndëve radioaktive”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**RREGULLORE
PËR TRANSPORTIN E SIGURT TË
LËNDËVE RADIOAKTIVE****Neni 1****Objekti i rregullore**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kërkesave bazë, të detyrueshme për zbatim nga personat fizikë dhe juridikë në lidhje me transportin e sigurt dhe sigurimin në transport të lëndëve radioaktive.

Neni 2**Fusha e zbatimit**

1. Transporti i lëndëve radioaktive kryhet me mjete të posaçme dhe nga persona fizikë ose juridikë, të cilët janë pajisur me licencë nga Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet (KMR), si dhe me miratimin përkatës nga Zyra për Mbrojtjen

nga Rrezatimet (ZMR) për çdo transport.

2. Kjo nuk i përjashton personat fizikë e juridikë nga detyrimet e tjera ligjore për transportin e mallrave të rrezikshme dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për sigurinë publike.

3. Kjo rregullore nuk është e zbatueshme në rastet kur:

a) lëndët radioaktive lëvizin brenda territorit të një institucioni të licencuar pa kaluar në rrugët publike;

b) lëndët radioaktive ndodhen brenda organizmit të njeriut ose të kafshëve me qëllim kurimi ose diagnostikimi;

c) lëndët radioaktive që ndodhen në produktet e konsumit të cilat janë miratuar si të tilla nga KMR-ja;

ç) burimet radioaktive të cilat janë pjesë e pandarë e transportit.

Neni 3**Përkufizime**

Për qëllim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime;

1. “Dërguesi”, çdo person fizik ose juridik, i cili përgatit ngarkesën për transport dhe emërtohet si dërgues i paketimit në dokumentet e transportit.

2. “Transportuesi”, çdo person fizik ose juridik, që merr përsipër transportin e lëndëve radioaktive me automjete të posaçme dhe emërtohet si i tillë në dokumentet e transportit.

3. “Marrësi”, çdo person fizik ose juridik, i cili merr në dorëzim paketimin me lëndën radioaktive dhe emërtohet si i tillë në dokumentet e transportit.

4. “Lëndë radioaktive”, çdo lëndë që përmban radionuclide, ku si përqendrimi i aktivitetit dhe aktiviteti total i tejkalojnë limitet.

5. “Paketimi”, tërësia e komponentëve të nevojshëm për të mbyllur plotësisht lëndën radioaktive.

6. “Pako”, paketimi së bashku me lëndën radioaktive të gatshme për transport.

7. “Sistemi i menaxhimit”, një grup elementesh bashkëvepruese për transportin e sigurt dhe sigurimin e tij për vendosjen e politikave e të objektivave, si dhe duke bërë të mundur realizimin e tyre në mënyrë efikase e efektive.

8. “Indeksi i transportit”, një numër që shënohet mbi pakon me lëndë radioaktive, i cili shërben për të kontrolluar ekspozimin ndaj rrezatimeve.



Neni 4

Përputhshmëria me detyrimet ndërkombëtare dhe kombëtare

Të gjitha transportet e lëndëve radioaktive në Shqipëri duhet të jenë në përputhje me rregullat ndërkombëtare dhe kombëtare për transportin e sigurt të lëndëve radioaktive, si dhe ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme”.

Neni 5

Aprovimi i transportit të lëndëve radioaktive

1. Transporti i lëndëve radioaktive në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet vetëm nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar, të cilët do të kenë një miratim të vlefshëm për transportin e lëndëve radioaktive, të lëshuar nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR).

2. Miratimi për lëndë radioaktive mund të jepet për transporte të njëpasnjëshme të këtyre lëndëve dhe është i vlefshëm deri në gjashtë muaj. Një miratim i tillë jepet vetëm nëse plotësohet kushti që transporti të kryhet në të njëjtën ditë të javës, në të njëjtën orë, në të njëjtën rrugë nga origjina deri në destinacion, me të njëjtat mjete dhe me të njëjtin drejtues mjete.

3. Forma e aprovimit miratohet nga KMR-ja.

4. Për të marrë miratimin e transportit, transportuesit paraqesin një kërkesë në KMR.

5. Miratimi i transportit duhet të përmbajë informacione, si më poshtë:

a) Një kopje të licencës për transportin e mallrave të rrezikshme, të lëshuar nga KMR-ja ose autoriteti kompetent jashtë vendit, kur është e aplikueshme;

b) Llojin/et e pakove që do të transportohen;

c) Një përshkrim të objekteve dhe pajisjeve që do të përdoren për ngarkimin, shkarkimin dhe trajtimin e pakove që do të transportohen;

ç) Një përshkrim të mjeteve dhe metodat që do të përdoren për paketimin dhe ruajtjen gjatë transportit;

d) Një përshkrim të mjeteve dhe metodave që do të përdoren për dekontaminimin e mjeteve të transportit dhe menaxhimin e mbetjeve radioaktive;

dh) Programin e mbrojtjes nga rrezatimi për transportin e lëndëve radioaktive;

e) Specifikimet teknike të lëndëve radioaktive që do të transportohen;

ë) Një përshkrim të mjeteve dhe procedurave që do të përdoren për të siguruar mbrojtjen fizike të lëndëve radioaktive, i cili duhet të jetë në përputhje me vendimin nr. 877, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores mbi sigurimin fizik të lëndëve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” dhe siç ndryshohet;

f) Të dhëna mbi personelin që do të merret me organizimin e transportit;

g) Një dëshmi që të gjithë drejtuesit e mjetit janë trajnuar për transportin e lëndëve radioaktive dhe kanë certifikatë ADR;

gj) Të dhëna për aktivitetin total të radionuklideve;

h) Miratimin e paketimit nga prodhuesi;

i) Të dhëna mbi formën fizike dhe kimike të lëndëve radioaktive;

j) Të dhëna për klasifikimin e paketimit;

k) Indeks in e transportit;

l) Numrin (UN) i cili identifikon rrezikshmërinë e lëndëve radioaktive;

ll) Certifikatën e cilësisë së burimeve;

m) Destinacionin final (emër dhe adresa e subjektit);

n) Çdo dokument shtesë tjetër të kërkuar nga KMR-ja.

6. Për subjekte të e regjistruara jashtë Shqipërisë, që duan të transportojnë përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësohen kriteret e ligjit nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme” dhe kriteret e përcaktuara në ndryshimet e propozuara. Këto subjekte duhet të pajisjen me miratim transporti nga ana e KMR-së.

Neni 6

Inspektimi i transportit të lëndëve radioaktive

1. KMR-ja, përmes ZMR-së, inspekton të gjitha elementet për sigurinë dhe sigurimin gjatë transportit të lëndëve radioaktive, në përputhje me ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen



evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe në aktet e tjera ndryshuese.

2. KMR-ja, nëpërmjet inspektorëve, kontrollon dhe programin për mbrojtjen nga rrezatimet gjatë transportit. KMR-ja verifikon gjatë transportit edhe kushtet e plotësuara për paketimin, si dhe miratimin e paketimit.

3. KMR-ja verifikon plotësimin e të gjitha kushteve të kësaj rregulloreje.

4. KMR-ja ka autoritetin për të ushtruar sanksione kur nuk plotësohen kushtet e sigurisë dhe sigurimit gjatë transportit të lëndëve radioaktive duke marrë në konsideratë riskun në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Sigurimi fizik i lëndëve radioaktive gjatë transportit

Transportuesit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që lënda radioaktiv të jetë e sigurt gjatë transportit, në mënyrë që të parandalohet vjedhja apo dëmtimi dhe të sigurohet kontrolli i duhur i lëndës, në përputhje me vendimin nr. 877, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores mbi sigurimin fizik të lëndëve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet ndryshuese.

Neni 8

Mbrojtja nga rrezatimi

1. Transportuesi duhet të krijojë dhe të zbatojë një program për mbrojtjen nga rrezatimi, duke përfshirë masat për mbrojtjen nga rrezatimi në proporcion me madhësinë dhe mundësinë e ekspozimeve të pritshme të rrezatimit.

2. Programi i mbrojtjes nga rrezatimi do të përfshijë masat:

a) për mbajtjen e dozës për publikun dhe punonjësit nën kufijtë e lejuar.

b) e duhura për optimizimin e mbrojtjes nga rrezatimi;

c) e ndihmës së shpejtë;

ç) për trajnimin e punonjësve në mbrojtjen nga rrezatimi.

3. Për ekspozimet profesionale, që rrjedhin nga aktivitetet e transportit të cilat janë të predispozuara të kalojnë 1 mSv në vit, transportuesi duhet të sigurojë monitorimin e ekspozimeve profesionale:

a) duke monitoruar vendin e punës, në rast se doza vlerësohet më e ulët se 6 mSv / vit; ose

b) duke monitoruar individin, në rast se doza vlerësohet më e lartë se 6 mSv / vit.

4. Programi i mbrojtjes nga rrezatimi dhe dokumentet e lidhura me të do t'i vihen në dispozicion KMR-së nga transportuesit, sipas kërkesës për inspektim.

Neni 9

Reagimi në rast emergjence

1. Masat e reagimit të shpejtë krijohen dhe zbatohen nga transportuesi, me qëllim që të mbrojnë personat, pronën dhe mjedisin në rast të aksidenteve apo incidenteve gjatë transportimit të lëndëve radioaktive.

2. Gjatë hartimit të procedurave për reagimin në rast emergjence duhen marrë në konsideratë dhe lëndët e tjera të rrezikshme që mund të rezultojnë nga reaksioni mes përmbajtjes së dërgesës dhe mjedisit në rast të një aksidenti.

3. Procedurat për reagimin në rast emergjence duhet të hartohen nga transportuesi në bashkëpunim me KMR-në, bazuar në planin e reagimit ndaj emergjencave radiologjike dhe Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

4. Kontrolli i zbatimit të procedurave për reagimin në rast emergjence është kompetencë e KMR-së në bashkëpunim me strukturat që anë përgjegjësi sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e emergjencave civile dhe krizave.

Neni 10

Sistemi i menaxhimit

1. Sistemi i menaxhimit, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe kombëtare, do të përcaktohet dhe do të zbatohet për të gjitha aktivitetet nga të gjithë personat fizikë e juridikë që marrin përsipër projektimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e paketimit, përgatitjen, transferimin, ngarkimin, transportin, shkarkimin dhe marrjen në destinacionin përfundimtar të ngarkesës së lëndëve radioaktive dhe pakos, në mënyrë që të sigurojë përputhshmërinë me dispozitat përkatëse të kësaj rregulloreje.

2. Specifikimet e projektimit duhet të merren nga prodhuesi dhe të vihen në dispozicion për KMR-në.

3. Prodhuesit, dërguesit ose transportuesit duhet të jenë të përgatitur:



a) të sigurojnë mjedise të përshtatshme për inspektim gjatë prodhimit të paketimeve siç e vendos KMR-ja;

b) të provojnë përputhshmërinë me ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe në aktet ndryshuese.

Neni 11

Rregullime të veçanta

1. KMR-ja mund të miratojë operacionet e transportit për një herë të vetme apo një seri të planifikuar dërgesash në bazë të miratimeve të veçanta, nëse transportuesi është në gjendje të provojë se standardet e kërkuara të sigurisë në këto rregullore do të respektohen.

2. Për dërgesat ndërkombëtare të këtij lloji, do të kërkohej të jetë marrë miratim nga të gjitha shtetet transite.

Neni 12

Trajnimi i punonjësve të përfshirë në transport

1. Të gjithë punonjësit e përfshirë në transportin e lëndëve radioaktive duhet të marrin trajnimin e duhur për mbrojtjen nga rrezatimi sipas programeve të miratuara.

2. Trajnimi do të verifikohet para dhe gjatë punësimit në një pozicion që përfshin transportin e lëndëve radioaktive dhe do të përsëritet në mënyrë periodike me ritrajnim çdo 5 vjet.

3. Të dhënat e të gjitha trajnimeve të ndërmarra do të mbahen nga punëdhënësi dhe do të vihen në dispozicion të të punësuarit dhe KMR-së, nëse kërkohej.

Neni 13

Njoftimi për transport

1. Transporti i lëndëve radioaktive kryhet vetëm pasi të jetë njoftuar dhe të jetë nxjerrë një miratim i posaçëm nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet. Njoftimi në Zyrën për Mbrojtjen nga Rrezatimet duhet të bëhet të paktën dy javë përpara se të kryhet transporti. Me realizimin e transportit, transportuesi është i detyruar të paraqesë në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet një kopje të dokumentit të dorëzimit të nënshkruar nga marrësi i lëndës radioaktive.

2. Çdo person juridik dhe fizik, i licencuar për transportin e lëndëve radioaktive, njofton dhe koordinon lëvizjet me autoritetet kombëtare, siç përcaktohet në vendimin nr. 877, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores mbi sigurimin fizik të lëndëve radioaktive në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet ndryshuese.

Neni 14

Kërkesa të përgjithshme për paketimet dhe pakot

1. Pakoja duhet të projektohet sipas masës së saj, volumit dhe formës që të mund të transportohet me lehtësi dhe siguri. Gjithashtu, duhet të sigurohet nivel i përshtatshëm i dozës brenda dhe jashtë mjetit gjatë transportit.

2. Projektimi i paketimit duhet të bëhet në mënyrë të tillë që çdo zhvendosje, ngritje, lëvizje e pakos të jetë e sigurt dhe, në rast aksidenti, integriteti i pakos nuk do të dëmtohet.

3. Lëndët që do të përdoren në sipërfaqen e jashtme të pakos për ta mbrojtur atë gjatë lëvizjes të jenë në përputhje me masën e saj.

4. Paketimi duhet të projektohet në mënyrë të tillë që sipërfaqet e jashtme të jenë të thjeshta për t'u dekontaminuar.

5. Shtresa e jashtme e pakos duhet të jetë e projektuar në mënyrë të tillë që të parandalojë mbledhjen dhe mbajtjen e ujit.

6. Çdo detaj që i shtohet pakos gjatë kohës së transportit, që nuk është pjesë e saj, nuk duhet të ulë sigurinë e saj.

7. Pakoja do të jetë e tillë që të përballojë efektet e çdo përshpejtimi, dridhjeve në kushtet e zakonshme të transportit, pa kompromentuar integritetin e pakos, si një e tërë.

8. Lëndët e paketimit dhe çdo komponent apo strukturë tjetër duhet të jenë fizikisht dhe kimikisht në përputhje me njëri-tjetrin dhe me përmbajtjen radioaktive, duke marrë parasysh sjelljen e tyre nën rrezatim.

9. Të gjitha valvulat përmes të cilave lënda radioaktive mund të hiqet, do të mbrohen kundër veprimeve të paautorizuara.

10. Projektimi i pakos do të marrë parasysh temperaturat e ambientit dhe presionin që mund të haset në kushte të zakonshme të transportit.

11. Një pako duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të sigurojë se në kushte të zakonshme të



transportit, me mbushjen maksimale të saj, niveli i rrezatimit në çdo pikë në sipërfaqen e jashtme të pakos nuk do t'i tejkalojë vlerat e përcaktuara në këtë rregullore.

12. Për lëndët radioaktive që kanë veti të tjera të rrezikshme, projektimi i pakos duhet të marrë në konsideratë edhe ato veti.

Neni 15

Kërkesa shtesë

1. Kërkesat shtesë për pako që transportohen duhet të zbatohen për të gjitha llojet e pakove siç kërkohet në ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe në aktet ndryshuese.

2. Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet mund të vlerësojë dhe të pranojë, rast pas rasti, certifikatën e paketimit të lëshuar nga trupa rregullatorë të vendit ku është prodhuar.

Neni 16

Klasifikimi i pakove

1. Klasifikimi i pakove lidhet me cilësinë e lëndës radioaktive që do të transportohet dhe me kërkesat që duhet të përmbushin paketimet në kushtet e një transporti normal dhe të një aksidenti që mund të ndodhë gjatë këtij transporti. Dërguesi është përgjegjës për përdorimin e paketimeve të përshtatshme, sipas ligjit nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe në aktet ndryshuese, duke marrë parasysh karakteristikat e lëndëve radioaktive që do të transportohen.

2. Pakot për transportin e lëndëve radioaktive klasifikohen, si më poshtë vijon:

a) Pako të përjashtuara do të thotë pako me artikuj konsumi ose instrumente që përmbajnë lëndë radioaktive me aktivitet, siç përcaktohet në ADR. Për transportin me postë aktiviteti total në çdo pako të përjashtuar nuk duhet të kalojë një të dhjetën e kufizimeve të specifikuar në ADR.

b) Pako industriale (IP-1, IP-2, IP-3) do të thotë paketim me lëndë radioaktive që kanë aktivitet specifik të ulët ose me objekte me sipërfaqe të kontaminuara. Në të gjitha rastet nivelet e rrezatimeve për këto pako nuk duhet të jenë më të

larta se 10 mSv/orë në distancën 3 m nga lënda i pambrojtur.

c) Pako të llojit A do të thotë paketime me lëndë radioaktive me aktivitet siç përcaktohet në ADR, nëse lënda radioaktive është në formë të posaçme ose nëse lënda radioaktive nuk është në formë të posaçme. Për përzierje radio-bërthamash, për të cilat aktivitetet përkatëse janë të njohura, duhet të zbatohen kushtet e ADR-së.

ç) Pako të llojit B(U) dhe B(M) do të thotë paketime që përmbajnë:

i) aktivitete jo më të vogla sesa ato të licencuara për performancën e paketimit;

ii) radiobërthama të njëjta me ato të autorizuar për performancën e paketimit;

iii) përbërje kimike dhe fizike të njëjtë me ato të licencuara për performancën e paketimit.

d) Pako të llojit C do të thotë pako që përmbajnë:

i) aktivitete jo më të vogla sesa ato të licencuara për performancën e paketimit;

ii) radiobërthama të njëjta me ato të autorizuar për performancën e paketimit;

iii) përbërje kimike dhe fizike të njëjtë me ato të licencuara për performancën e paketimit.

Neni 17

Kategorizimi i transportit

1. Çdo pako, përveç pakove të përjashtuara, duhet të përfshihet në njërin nga kategoritë e mëposhtme, duke mbajtur parasysh nivelin e rrezatimit në sipërfaqe të pakos si dhe indeksin e transportit:

Kategoria e transportit	Niveli më i lartë i rrezatimit në sipërfaqen e jashtme të paketimit	Indeksi i transportit
I – E BARDHË	Deri në 0.005mSv/h	0
II – E VERDHË	Nga 0.005mSv/h deri 0.5mSv/h	0 deri 1
III – E VERDHË	Nga 0.5mSv/h deri 2mSv/h	1 deri 10
III – E VERDHË	Nga 2 mSv/h deri 10mSv/h Në kushte të veçanta të miratuara nga ZMR	Më shumë se 10

2. Indeksi i transportit i një paketimi është vlera e nivelit të rrezatimit (fuqia e dozës) në mSv/orë në distancën 1 m nga sipërfaqja e jashtme e tij e shumëzuar me 100.



Neni 18

Etiketa e pakove

1. Çdo pako, përveç pakove të përjashtuara, duhet të ketë një etiketë, në përputhje me modelet e treguara në aneksin I, bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Këto etiketa duhet të ngjiten në dy anë të kundërta të paketimit.

2. Automjetet që transportojnë lëndë radioaktive duhet të mbajnë në hyrjet ku ka akses personeli shenjën e rrezikut radioaktiv, sikurse tregohet në aneksin I.

Neni 19

Tabelat e jashtme

Tabelat e jashtme duhet të jenë në përputhje me modelet e përcaktuara në aneksin II dhe ato të përcaktuara në ligjin nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen evropiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe në aktet ndryshuese.

Neni 20

Përgjegjësitë e dërguesit

Përveç rasteve kur parashikohet e kundërta në këtë rregullore, asnjë person nuk mund të transportojë lëndën radioaktive nëse nuk është shënuar, etiketuar, afishuar siç duhet, të përshkruar dhe të certifikuar në një dokument transporti dhe në gjendje për transport, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 21

Ndarja gjatë transportit

Pakot mbi paketimet dhe kontejnerët e mallrave që përmbajnë lëndë radioaktive dhe lëndë të paambalazuara radioaktive duhet të ndahen gjatë transportit dhe gjatë magazinimit në transit:

a) nga punëtorët që rregullisht punojnë në zona me distancë të llogaritura me një kriter doze prej 5 mSv në një vit dhe parametrat konservatorë të modelit;

b) nga anëtarët e publikut në zonat ku publiku ka akses në distanca të llogaritura duke përdorur një kriter dozë prej 1 mSv në një vit dhe parametrat konservatorë të modelit;

c) nga një film i pazhvilluar fotografik në distanca të llogaritura duke përdorur një kriter të

ekspozimit në rrezatim për filmin e pazhvilluar fotografik e 0.1 mSv për dorëzimin e një filmi të tillë.

Neni 22

Magazinimi gjatë transportit dhe magazinimi në transit

1. Të gjitha dërgesat do të magazinohen në mënyrë të sigurt.

2. Niveli i rrezatimit në kushtet e zakonshme të transportit nuk duhet të kalojë 2 mSv orë në çdo pikë të sipërfaqes së jashtme të mjetit dhe 0.1 mSv/h në 2 m distancë nga sipërfaqja e jashtme e mjetit.

Neni 23

Kushte shtesë

1. Procesi i ngarkimit të pakove me lëndë radioaktive, transportimi i tyre dhe shkarkimi kryhen kurdoherë nën kontrollin e vazhdueshëm të një personi të kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet.

2. Ndalohej kategorikisht transportimi i paketimeve me lëndë radioaktive së bashku me lëndë të tjera të rrezikshme ose me ushqime, filma fotografikë të pazhvilluar ose me lëndë të tjera të ndjeshme ndaj dritës.

Neni 24

Dokumentacioni që shoqëron ngarkesën gjatë transportit

1. Dokumentacioni i transportit që shoqëron ngarkesën e lëndës radioaktive duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) Deklaratë nga dërguesi i pakos me lëndë radioaktive në të cilën tregohet se paketimi dhe etiketimi janë kryer në përputhje me dispozitat përkatëse të rregullores;

b) Emrat dhe adresat e sakta të dërguesit, transportuesit dhe marrësit të mallit;

c) Numrin dhe datën e lëshimit të licencave për dërguesin, transportuesin dhe marrësin;

ç) Emrin dhe simbolin për çdo radio-bërthamë që transportohet, si dhe aktivitetin e tyre;

d) Përshkrimin e formës kimike dhe fizike të lëndës radioaktive, si dhe formën e posaçme ose jo të saj;

dh) Kategorinë e paketimit (I – E BARDHË, II – E VERDHË, III – E VERDHË);

e) Indeksën e transportit.

2. Të gjitha dokumentet shoqëruese duhet të kenë nënshkrimin dhe vulën e subjekteve që marrin pjesë në procesin e transportit. ZMR-ja ka të drejtën e ushtrimit të kontrollit në çdo kohë mbi subjektet e licencuara lidhur me saktësinë e dokumentacionit të transportit, elementet e sigurimit, sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimet.

Neni 25

Kalimi përmes doganës

1. Autoritetet doganore, në bashkëpunim me Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet, përcaktojnë zonat dhe kriteret që duhet të përmbushen për të garantuar mbrojtjen nga rrezatimet dhe sigurimin fizik.

2. Importi dhe eksporti i paketimeve me lëndë radioaktive nga subjektet e licencuara, si dhe veprimet përkatëse në organet doganore bëhen vetëm mbi bazën e një miratimi të posaçëm që subjekti e siguron nga ZMR-ja, e cila duhet të paraqitet në origjinal në çdo rast kur subjekti importon ose eksporton lëndë radioaktive.

Neni 26


Aksidentet gjatë transportit

1. Në rast aksidenti gjatë transportit të lëndëve radioaktive njoftohet menjëherë Qendra Kombëtare Operacionale e Menaxhimit të Emergjencave, Qendra e Fizikës Bërthamore të Aplikuar, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, të cilat zbatojnë dispozitat e Planit Kombëtar të Emergjencave Radiologjike. Transportuesi merr të gjitha masat për parandalimin e ekspozimeve shtesë dhe ka përgjegjësinë kryesore për sigurinë, sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimet.


2. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të detyruar të zbatojnë me rreptësi të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje, si dhe dispozitat e tjera ekzistuese që lidhen me transportin në Republikën e Shqipërisë.

ANEKSI I


SHENJAT E RREZIKUT RADIOAKTIV DHE ETIKETAT E KATEGORIVE TË TRANSPORTIT




Shenja e rrezikut radioaktive në ngjyrë të zezë



Kategori e parë e bardhë



Kategori II-e verdhë



Kategori III- e verdhë


ANEKSI II

TABELAT E JASHTME

Tabelat e jashtme duhet të kenë formën si në figurë dhe të mbajnë nr. 7, e cila duhet të jetë jo më e vogël se 25mm në gjatësi, e vendosur në fushë gjysmë të verdhë lart, gjysmë të bardhë poshtë dhe të përmbajë shenjëën e rrezikut radioaktiv.



Tabela e jashtme duhet të përmbajë dhe numrin UN, i cili vendoset në fushë të verdhë. Yjet në fushë presupozojnë numrat në tabelë. Tabela nuk mund të ketë përmasa më të vogla se ato që tregohen në figurë.



**VENDIM****Nr. 816, datë 16.11.2016****PËR STRUKTURËN, KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE MARRËDHËNIET E PUNËS SË PUNONJËSVE TË NJËSISË PËRGJEGJËSE NË AUTORITETET PUBLIKE, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 60/2016, “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në autoritetet publike me mbi 80 të punësuar përbëhet nga dy nëpunës/punonjës.

2. Njësia përgjegjëse në autoritetet publike është drejtuesi i strukturës së auditimit të brendshëm dhe një nëpunës/punonjës i saj. Në mungesë të tyre, kjo njësi përbëhet nga dy nëpunës/punonjës të njësisë së auditimit të brendshëm.

3. Në ato raste kur autoriteti publik nuk ka në strukturën e tij strukturë auditimi të brendshëm, njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është drejtuesi i strukturës së burimeve njerëzore dhe një nëpunës/punonjës i saj. Në mungesë të tyre, kjo njësi përbëhet nga dy nëpunës/punonjës të strukturës së burimeve njerëzore.

4. Autoritetet publike, të cilat në strukturën e tyre kanë njësi të posaçme, ndër të tjera, për luftën ndaj korrupsionit dhe praktikave apo veprimeve të dyshuara të korrupsionit, kryejnë edhe detyrën e njësisë përgjegjëse, në zbatim të ligjit nr. 60/2016.

5. Në ato autoritete publike, në të cilat nuk mund të zbatohen pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi, për shkak se nuk kanë strukturë auditimi apo të burimeve njerëzore ose nuk plotësohet numri, sipas pikës 1, të këtij vendimi, njësia përgjegjëse plotësohet ose përbëhet nga dy nëpunës/punonjës të përhershëm të autoritetit, të cilët, përveç detyrave që kryejnë dhe kushteve/kritereve të përgjithshme e të veçanta, të përcaktuara në legjislacionin që rregullon marrëdhënien e punës, duhet të plotësojë edhe këto kushte:

Faqe | 23872

a) Të kenë vjetërsi në punë jo më pak se dy vjet;
b) Të kenë mbaruar arsimin e lartë, i preferueshëm në shkencat juridike, shkencat sociale ose shkencat ekonomike;

c) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

6. Autoritetet publike, që kanë degë territoriale në Republikën e Shqipërisë, krijojnë njësinë përgjegjëse vetëm në strukturën qendrore të tyre.

7. Çaktimi si nëpunës/punonjës i njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në autoritetin publik, krahas detyrave dhe funksioneve të pozicionit të punës, sipas aktit të emërimit, është pa afat dhe përfundon me mbarimin e marrëdhënieve në atë pozicion pune.

8. Njësia përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016, si strukturë që ndjek në vazhdimësi sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në veprimtarinë e saj, mban kontakte të vazhdueshme me ILDKPKI-në. Njësia përgjegjëse në sektorin publik vepron në mënyrë të pavarur dhe jashtë çdo influence tjetër, të padrejtë, që mund të pengojë realizmin e detyrave të saj në zbatim të ligjit nr. 60/2016.

9. Për çdo ndërprerje të marrëdhënies së punës ndërmjet autoritetit publik dhe nëpunësit /punonjësit të njësisë përgjegjëse, informohet menjëherë ILDKPKI-ja. Titullari i autoritetit publik merr masat e nevojshme që të zëvendësojë menjëherë nëpunësin/punonjësin e larguar të njësisë përgjegjëse me punonjës të strukturës përkatëse ose, sipas rastit, të strukturave të tjera, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

10. Nëpunësit/punonjësit e njësisë përgjegjëse largohen nga kjo detyrë me urdhër të titullarit të autoritetit publik, kur:

a) japin dorëheqjen me shkrim nga detyra e njësisë përgjegjëse, e cila i dërgohet, njëkohësisht, edhe ILDKPKI-së;

b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

c) kryejnë shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;

ç) përfundon marrëdhënien e punës me autoritetin publik.

11. Titullarët e autoriteteve publike emërojnë nëpunësit/punonjësit në detyrën e njësisë përgjegjëse brenda 15 ditësh, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe njoftojnë me shkrim inspektorin



e përgjithshëm të ILDKPKI-së për krijimin e njësinë përgjegjëse, së bashku me kontaktet e saj.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 7790, datë 24.11.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave e të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 25.11.2016, ora 11:00, deri në datën 29.11.2016, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Eridian Salianji.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Eridian Salianji, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 392 lekë